Zona në të cilën nuk janë përqendruar një ose më tepër organizma të dëmshëm edhe pse ka kushte të volitshme për përqendrimin e të njëjtëve aty, ose zona në të cilën ka rrezik që organizma të caktuar të dëmshëm të sulmojnë bimë të caktuara në kushte të volitshme ekologjike edhe për faktin se ata organizma nuk janë përqendruar aty, mund të caktohet si zonë e mbrojtur.

Organizmi i dëmshëm konsiderohet si i përqendruar në zonën e mbrojtur, nëse dihet se i njëjti është paraqitur aty dhe se nuk janë marrë masa fitosanitare për zhdukjen e tij ose nëse masat e tilla kanë qenë joefikase për periudhën prej së paku dy vitesh të njëpasnjëshëm.

Në zonën në të cilën nuk janë përqendruar një ose më tepër organizma të dëmshëm edhe përkundër kushteve të volitshme për përqendrimin e tyre dhe e njëjta në mënyrën e paraparë paraprakisht është definuar si zonë e mbrojtur, Drejtoria fitosanitare obligohet të kryejë ose të sigurojë kryerjen e kontrolleve të rregullta e sistematike për praninë e organizmave të dëmshëm për të cilët zona e mbrojtur është definuar si e tillë. Në zonën e mbrojtur në të cilën ka rrezik nga paraqitja e organizmave të caktuar të dëmshëm te disa bimë në kushte të volitshme ekologjike edhe kur këto organizma nuk janë të paraqitura në Republikën e Maqedonisë, kontrollimet sistematike kryhen me zgjedhje të lirë/të pa obligueshme.

Mënyrën e përcaktimit të zonës së mbrojtur, kushtet për kryerjen e kontrollimeve sistematike dhe listat e zonave të mbrojtura i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

## **B) Ndalimet dhe kufizimet**

#### Neni 14

##### **Ndalimi për futjen dhe përhapjen e organizmave të dëmshëm**

Futja dhe përhapja e organizmave të dëmshëm të shënuar në Listën I.A dhe Listën II.A ndalohet.

Futja dhe përhapja e organizmave të dëmshëm të shënuar në Listën I.B dhe Listën II.B në kuadër të zonës së mbrojtur, për të cilat zona e mbrojtur është definuar si e tillë, ndalohet.

Të gjitha futjet me ose pa qëllim të organizmave të dëmshëm në territorin e Republikës së Maqedonisë ose në ndonjë zonë të mbrojtur, konsiderohen si futje në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

Futja dhe përhapja e organizmave të dëmshëm që nuk janë përfshirë në Listat nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni ndalohet, nëse ekziston rreziku për shëndetin e bimëve në territorin e Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 15

##### **Ndalimi për importin dhe bartjen e bimëve, prodhimeve bimore dhe lëndëve e objekteve të tjera**

Importi i bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve e lëndëve të tjera të shënuara në Listën III.A ndalohet.

Importi i bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve e lëndëve të tjera të shënuar në Listën III.B në kuadër të zonës së mbrojtur, për të cilat zona e mbrojtur është definuar si e tillë, ndalohet.

Nëse kushtet e përcaktuara fitosanitare nuk janë plotësuar, ndalohet importi dhe bartja e bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve e lëndëve të tjera të shënuara në Listën IV.A.

Nëse kushtet e përcaktuara fitosanitare nuk janë plotësuar, ndalohet importi ose bartja e bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve e lëndëve të tjera të shënuara në Listën IV.B në kuadër të zonës së mbrojtur, për të cilat zona e mbrojtur është definuar si e tillë.

Importi dhe bartja e llojeve të tjera të bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve e lëndëve të tjera që nuk janë shënuar në Listat nga paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni ndalohet, nëse ekziston rreziku për shëndetin e bimëve në territorin e Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 16

##### **Përrjashtime për punët eksperimentale, shkencore-hulumtuëse, selektive ose zhvillimore**

Me përjashtim të dispozitave nga nenet 14 dhe 15 të këtij ligji, institucionet shkencore dhe hulumtuëse të autorizuar nga ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, mund të importojnë ose të lëshojnë në qarkullim organizma të dëmshëm të shënuar në Listat I.A, II.A, I.B dhe II.B dhe bimë, prodhime bimore dhe objekte e lëndë të tjera të shënuara në Listat III.A, III.B, IV.A dhe IV.B nëse:

- të njëjtët shfrytëzohen për punët eksperimentale, shkencore-hulumtuese, selektive ose zhvillimore;

- ato i plotësojnë kushtet për kapacitetet shkencore dhe teknike;

- kanë personin e punësuar me së paku përgatitje shkollore të kryer të shkallës VII-2 nga sfera e mbrojtjes së bimëve;

- kanë leje për import.

Lejen për import nga paragrafi 1 i këtij neni e lëshon Drejtoria fitosanitare në bazë të kërkesës nga institucionet e shënuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Kërkesa veçanërisht përmban:

- të dhëna për kërkuesin (emrin, selinë, numrin e regjistrimit);

- të dhëna për organizmat e dëmshëm ose bimët, prodhimet bimore dhe lëndët e objektet e tjera;

- të dhëna për mënyrën dhe qëllimin e shfrytëzimit dhe masat për pengimin e përhapjes.

Drejtoria fitosanitare mban evidencë për importin nga paragrafi 1 i këtij neni.

Kapacitetet shkencore dhe teknike nga ky nen, i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

#### Neni 17

##### Rastet e veçanta

Me përjashtim të dispozitave nga nenet 14 dhe 15 të këtij ligji, Drejtoria fitosanitare sipas kushteve të përcaktuara dhe nëse nuk ka rrezik nga përhapja e organizmave të dëmshëm, në raste të veçanta mund të lejojë:

- importin e bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve e lëndëve të tjera, të cilat janë kultivuar ose shfrytëzohen në zonën më të afërt kufitare, nëse të njëjtat janë dedikuar për përdorim në zonën më të afërt kufitare në Republikën e Maqedonisë;

- importin e bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve e lëndëve të tjera në rast se ka kontaminim të vogël me organizma të dëmshëm, përveç bimëve të dedikuara për mbjellje,

Drejtoria fitosanitare mban evidencë për importin ekskluziv nga ky nen.

Kushtet për kryerjen e importit ekskluziv të bimëve, prodhimeve bimore dhe lëndëve e objekteve të tjera nga paragrafi 1 të këtij neni, më afër i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

#### Neni 18

##### Përjashtimet

Dispozitat e neneve 14 dhe 15 të këtij ligji nuk kanë të bëjnë me:

- dërgesat në transit përmes territorit të Republikës së Maqedonisë;

- sasi të vogla të bimëve, prodhimeve bimore dhe lëndët e objektet e tjera, duke përfshirë edhe produktet ushqimore, nëse të njëjtat përdoren nga pronari ose pranuesi për qëllime jo komerciale ose jo industriale ose për konsumim gjatë transportit.

Me sasi të vogla nga paragrafi 1 alineja 2 të këtij neni nënkuptojmë: pemë e perime të freskëta, përveç patateve, qepujka ornamentale, drurëve për këshëndella pa rrënjë, të dedikuara ekskluzivisht për përdorim personal të shfrytëzuesit të fundit në sasi të përcaktuara nga ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

**C) Regjistri i prodhuesve, përpunuesve, importuesve dhe distribuesve të bimëve, prodhimeve bimore dhe lëndëve e objekteve të tjera**

#### Neni 19

##### Regjistri

Vetëm personat fizikë dhe juridikë, të cilët i përmbushin kushtet e përcaktuara për kryerjen e aktiviteteve për të cilat janë regjistruar në gjyq dhe të cilët

janë futur në regjistrin e prodhuesve, përpunuesve, importuesve dhe distribuesve të bimëve, prodhimeve të bimëve dhe objekteve dhe lëndëve tjera (në tekstin e mëtejshëm: regjistri) sipas këtij ligji, mund të merren me prodhim, përpunim, import ose distribuim të bimëve, prodhimeve të bimëve dhe objekteve dhe lëndëve tjera nga Lista V.A dhe Lista V.B.

Futja në regjistër është e detyrueshme për:

- prodhuesit, përpunuesit dhe distribuesit e bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve dhe lëndëve tjera nga Lista V.A.;

- importuesit e bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve dhe lëndëve tjera të shënuara në Listën V.B.;

- prodhuesit e bimëve të veçanta, prodhuesit e bimëve dhe objektet dhe lëndët tjera që nuk janë të shënuara në Listën V.A. dhe qendrat relevante për grumbullim dhe dërgimin në lëmin e prodhimit.

Regjistri do të vendoset dhe do të udhëhiqet nga Drejtoria fitosanitare.

Regjistrimi bëhet me paraqitjen e kërkesës për regjistrim në regjistër.

Kërkesa veçanërisht përmban:

- të dhëna për kërkuesin: emërtimin respektivisht emrin, selinë respektivisht adresën, personin përgjegjës dhe numrin tatimor dhe numrin unik të amzës;

- numrin e regjistrimit gjyqësor;

- formën juridike dhe organizative;

- llojin e veprimtarisë;

- të dhënat për truallin bujqësor që shfrytëzohet – numrin e kadastrit PK-parcela dhe numrin e komunës së kadastrit;

- të dhëna për personin përgjegjës për shëndetin e bimëve: emrin dhe mbiemrin, numrin tatimor (NUAQ), respektivisht numrin tatimor për personin juridik, selinë e regjistruar dhe adresën.

Personi përgjegjës për shëndetin e bimëve në personin juridik ose fizik duhet të ketë më së paku arsim sipëror nga lëmi i shkencave të bujqësisë (prodhimit bimor) ose nga lëmi i shkencave të pylltarisë.

Drejtori i Drejtorisë fitosanitare merr vendim për futjen në regjistër jo më vonë se tre muaj pas pranimit të kërkesës me komplet dokumentacionin.

Nëse personi përgjegjës për shëndetin e bimëve pushon t'i plotësojë obligimet e përcaktuara në nenin 21 nga ky ligj, drejtori i Drejtorisë fitosanitare me detyrë zyrtare merr vendim për shlyerjen e saj nga regjistri.

#### Neni 20

##### Përmbajtja e regjistrit

Regjistri kryesisht i përmban të dhënat vijuese:

- numrin e regjistrimit gjyqësor, numrin tatimor;

- emërtimin e personit juridik ose emrin dhe mbiemrin e personit fizik dhe selinë e regjistruar ose adresën.

- personin përgjegjës të subjektit juridik;

- formën juridike dhe organizative;

- llojin e veprimtarisë;

- tokën bujqësore e cila shfrytëzohet sipas parcelave dhe llojin e shfrytëzimit;

- numrin e komunës së kadastrit dhe numrin e PK parcelës;

- personin përgjegjës për shëndetin e bimëve.

Regjistri mbahet në formë të shkruar dhe elektronike.

Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit e përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

#### Neni 21

##### Obligimet e personit përgjegjës për shëndetin e bimëve sipas regjistrit

Personi përgjegjës për shëndetin e bimëve nga neni 19 paragrafi 6 nga ky ligj është i detyruar të:

- mbajë evidencë të saktë dhe precize për prodhimin, përpunimin dhe qarkullimin e bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve dhe lëndëve tjera, të cilat i blejnë për

deponimin ose mbjellje në lokale, të cilat i prodhon ose ofron për shitje dhe dokumentet për to t'i ruajë më së paku një vit;

- mbajë dhe azhurnojë plan në vendet ku i kultivon, prodhon, deponon, ruan ose shfrytëzon bimët, prodhimet bimore dhe objektet dhe lëndët tjera.

- bëjë kontrolle të rregullta vizuale për shëndetin e bimëve;

- mundësojë qasje inspektorit fitosanitar për kryerjen e inspektimit fitosanitar të bimëve, lokaleve dhe dokumenteve edhe gjatë marrjes së mostrave oficiale;

- informojë menjëherë Drejtorinë fitosanitare dhe inspektorin fitosanitar për të gjitha dukuritë e papritura të organizmave të dëmshëm, simptomave ose dukurive tjera të veçanta për bimët si dhe për prodhimin dhe dukurinë e llojeve të bimëve të ndaluara;

- informojë menjëherë Drejtorinë fitosanitare për të gjitha ndryshimet e të dhënave në regjistër;

- informojë inspektorin fitosanitar çdo vit për masën dhe vendin e prodhimit ose përpunimit të bimëve, prodhimeve të bimëve dhe objekteve dhe lëndëve tjera;

- bashkëpunojë me Drejtorinë fitosanitare dhe/ose inspektorin fitosanitar për sigurimin e shëndetit të mirë të bimëve.

Mënyrën e mbajtjes së evidencës, mënyrën e zbatimit të kontrolleve të shëndetit të bimëve, përmbajtjen dhe mënyrën e informimit për të dhënat nga paragrafi 1 i këtij neni i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

#### Neni 22

##### **Përfashtime**

Me përfashtim të nenit 19 paragrafët 1 dhe 2 nga ky ligj, futja në regjistër nuk është e detyrueshme për prodhues të vegjël ose përpunues, nëse prodhimi i tyre i përgjithshëm ose përpunimi dhe shitja e bimëve, prodhimeve të bimëve dhe objekteve dhe lëndëve tjera dedikimi për përdorim personal ose për konsumim të fundit nga ana e personit fizik në treg lokal që nuk është inkuadruar profesionalisht në prodhim dhe përpunim të bimëve dhe në mungesë të rrezikut nga zgjerimi i organizmave të dëmshme.

Kriteret më të përafërta për përcaktimin e prodhuesve të vegjël ose përpunuesve dhe tregjeve lokale i rregullon ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

## 2. IMPORTI, EKSPORTI DHE TRANSITI I DËRGESAVE

### A) Importi

#### Neni 23

##### **Vendi i hyrjes**

Dërgesat për të cilat është i obliguar inspeksioni fitosanitar mund të importohen nëpërmjet vendeve të caktuara të hyrjes në Republikën e Maqedonisë, të cilat i plotësojnë kushtet për kryerjen e inspektimit fitosanitar sipas këtij ligji.

Kushtet për kryerjen e inspektimit fitosanitar dhe vendet e hyrjes i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 24

##### **Importi**

Dërgesat nga Lista V.B.I që janë importuar në vend, paketimi i tyre, dhe nëse është e nevojshme edhe automjeti në të cilat ka qenë transportuar, doemos duhet t'i nënshtrohen inspektimit fitosanitar.

Me inspektimin fitosanitar duhet të konstatohet se dërgesat:

- a janë të shoqëruara me certifikatë fitosanitare;

- nuk janë të sulmuara nga organizmat e dëmshëm nga Lista I.A dhe II.A;

- nuk përmbajnë bimë, prodhime bimore ose objekte dhe lëndë tjera nga Lista III.A;

- i përmbushin kushtet e veçanta fitosanitare të përmendura në Listën IV.A.

Dërgesat nga paragrafi 1 nga ky nen doemos duhet të kenë certifikatë fitosanitare origjinale të lëshuar nga vendi i prejardhjes, përveç kur kushtet e veçanta fitosanitare të përmendura në Listën IV.A ose IV.B për lloje të veçanta të dërgesave të cilat i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave mund të plotësohen edhe në vendin që nuk është vend i prejardhjes.

Dërgesat nga paragrafi 1 nga ky nen të cilat pas lëshimit të certifikatës fitosanitare në vendin e prejardhjes janë dërguar, deponuar, ripaketuar ose ndarë në vend tjetër që nuk është vend i prejardhjes përveç certifikatës origjinale ose kopjes së vërtetuar të të njëjtës doemos duhet të kenë edhe certifikatë fitosanitare për riekспорт të lëshuar në vendin e dytë. Nëse dërgesat e tilla paraprakisht më pas janë importuar në disa vende të ndryshme dhe janë dhënë më shumë se një certifikatë fitosanitar për riekспорт, përveç certifikatës fitosanitare origjinale ose kopjes së saj të vërtetuar, ato doemos duhet t'i posedojnë edhe të gjitha certifikatat tjera fitosanitare ose kopje të tyre të vërtetuara.

Inspektimi fitosanitar mund të bëhet edhe për dërgesat tjera, nëse inspektorin fitosanitar dyshon se të njëjtat paraqesin rrezik për shëndetin e bimëve në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Mënyrën e kryerjes së inspektimit fitosanitar nga paragrafi 1 nga ky nen, e përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

#### Neni 25

##### **Importi në zonën e mbrojtur**

Dërgesat nga Lista V.B që janë importuar në zonën e mbrojtur, përveç kushteve të përcaktuara me nenin 24 nga ky ligj, doemos duhet t'i plotësojnë edhe kushtet vijuese:

- të mos jenë të sulmuara nga organizmat të dëmshëm nga Lista e I.B dhe II.B;

- të mos përmbajnë bimë, prodhime bimore ose objekte dhe lëndë tjera nga Lista III.B;

- t'i përmbushin kushtet fitosanitare nga Lista IV.B.

#### Neni 26

##### **Puna eksperimentale, shkencore-hulumtuese, seleksionuese ose zhvillimore**

Dërgesat nga Lista V.B, të cilat janë dedikuar për shfrytëzim në punën eksperimentale, shkencore-hulumtuese, seleksionuese ose zhvillimore, doemos duhet t'i nënshtrohen inspektimit fitosanitar, të posedojnë leje për import të definuar në nenin 16 nga ky ligj dhe certifikatë fitosanitare nga vendi i prejardhjes.

#### Neni 27

##### **Raste të veçanta**

Nëse nuk ekziston asnjë rrezik nga zgjerimi i organizmave të dëmshëm, Drejtoria fitosanitare në pajtim me kushtet e përcaktuar në nenin 17 nga ky ligj, mund të lejojë importin e bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve dhe lëndëve të tjera nga Lista V.B, të cilat janë kultivuar ose shfrytëzuar në zonën më të afërt kufitare pa certifikatë fitosanitare dhe pa inspektim fitosanitar, nëse të njëjtat janë dedikuar për përdorim në zonën më të afërt kufitare.

#### Neni 28

##### **Përfashtime**

Sasitë e vogla të bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve dhe lëndëve tjera nga Lista V.B, në pajtim me dispozitat nga neni 18 nga ky ligj, mund të importohen pa certifikatë fitosanitare.

Inspeksioni fitosanitar i dërgesave nga paragrafi 1 nga ky nen bëhet vetëm me vlerësimin e inspektorit fitosanitar.

#### Neni 29

##### **Obligimet e importuesve dhe nëpunësve të doganës**

Importuesi, transportuesi ose qytetarët të cilët sjellin dërgesa të përmendura në nenin 24 paragrafi 1 nga ky ligj në Republikën e Maqedonisë, doemos duhet ta informojnë inspektorin fitosanitar për arritjet e dërgesave, të cilat janë importuar ose ngarkuar gjatë kohës së transportit.

Nëpunësit e doganës, nuk mund të fillojnë me procedurat për doganimin, përveç gjatë transitit, deri sa inspektori fitosanitar nuk bën inspektim fitosanitar të dërgesave të përmendura në paragrafin 1 nga ky nen dhe nuk e lejon importin.

Importuesi është i detyruar t'i zbatojë masat e përmendura nga ana e inspektorit fitosanitar për dërgesat që importohen.

Nëpunësit doganorë e ndalojnë importin dhe ia dorëzojnë inspektorit fitosanitar bimët, prodhimet bimore dhe objektet dhe lëndët tjera të cilat qytetari i ka sjellë në Republikën e Maqedonisë pa certifikatë fitosanitare ose të cilat kanë qenë të përmendura në Listën III.A ose Listën III.B, me përjashtim të sasive të vogla nga neni 18 nga ky ligj, i cili përsëri urdhëron marrjen e masave nga neni 10 paragrafi 3 nga ky ligj.

Neni 30

#### **Procedurat gjatë importit**

Inspektimi fitosanitar i dërgesave nga neni 24 nga ky ligj bëhet në vend të parë në hyrje të Republikës së Maqedonisë, ku bëhen edhe formalitetet tjera administrative për import, duke përfshirë edhe doganimin.

Nëse nuk ekziston rrezik nga zgjerimi i organizmave të dëmshëm, inspektori fitosanitar mund të lejojë që kontrolltet e shëndetit të bimëve nga dërgesat të zbatohen edhe në lokacione të caktuara në brendinë e Republikës së Maqedonisë nën mbikëqyrje të doganës.

Neni 31

#### **Lejimi ose refuzimi i importit**

Nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 24 ose nenin 25 nga ky ligj, inspektori fitosanitar pas zbatimit të inspektimit fitosanitar e lejon importin e dërgesave dhe vë vulë katrore në certifikatën fitosanitare ose certifikatën fitosanitar për riekспорт me datën e hyrjes dhe vulë nga inspektori fitosanitar.

Nëse kushtet nga neni 24 ose neni 25 nga ky ligj nuk janë plotësuar, inspektori fitosanitar, nuk do të lejojë importin e dërgesës dhe urdhëron marrjen e një ose më shumë masave të definuara në nenin 10 paragrafi 3 nga ky ligj. Në atë rast, inspektori fitosanitar vë shenjë të kuptueshme në certifikatën fitosanitare ose në certifikatën fitosanitare për riekспорт, vulë të kuqe trekëndëshe, me çka certifikata bëhet e pavlefshme.

Nëse gjatë inspektimit fitosanitar konstatohet se një pjesë e dërgesës është sulmuar nga organizma të dëmshëm të përmendura në Listën I.A, I.B, II.A ose II.B, importi i pjesës së ngelur nga dërgesa mund të lejohet nëse nuk ekziston dyshimi për praninë e organizmave të dëmshëm në atë pjesë të dërgesës dhe nëse nuk ekziston rrezik nga zgjerimi i të njëjtëve.

Firmën dhe përmbajtjen e vulës katrore të përmendur në paragrafët 1 dhe 2 nga ky nen i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Neni 32

#### **Dërgesa tjera gjatë importit**

Në rast të importit, që, sipas dokumenteve shoqëruese, nuk përfshin bimë, prodhime bimore dhe objekte dhe lëndë tjera të përmendura në Listën V.B, inspektori fitosanitar mund të bëjë inspektim fitosanitar nëse ekziston dyshim i bazuar në lidhje me identitetin e dërgesës ose ekziston rrezik nga zgjerimi i organizmave të dëmshëm.

Nëse pas kryerjes së inspektimit fitosanitar, inspektori fitosanitar ende dyshon në identitetin e dërgesës, veçmas në lidhje me gjininë, llojin ose prejardhjen, dërgesa konsiderohet se përmban bimë, prodhime bimore dhe objekte dhe lëndë tjera të përmendura në Listën V.B.

Neni 33

#### **Zonat e lira ekonomike**

Për dërgesat që janë importuar në zonat e lira ekonomike ose në depo doganore në Republikën e Maqedonisë, zbatohen dispozitat nga neni 23 deri 32 nga ky ligj, që kanë të bëjnë me importin e dërgesave.

## **B) Eksporti**

Neni 34

#### **Procedurat gjatë eksportit**

Nëse vendi në të cilin eksportohen dërgesa me prejardhje nga Republika e Maqedonisë kërkon certifikatë fitosanitare, inspektori fitosanitar bën inspektim fitosanitar të dërgesës para se të japë certifikatë fitosanitare që të garantohet se janë plotësuar kushtet e përcaktuara fitosanitare të vendit në të cilin eksportohet dërgesa.

Nëse vendi në të cilin eksportohet dërgesa, që nuk rrjedh nga Republika e Maqedonisë, por ka qenë e deponuar, ose ripaketuar ose ndarë në Republikën e Maqedonisë kërkon certifikatë fitosanitare, inspektori fitosanitar bën inspektimin fitosanitar të dërgesës para se të japë certifikatë fitosanitar për riekспорт që të garantohet se janë plotësuar kushtet e parapara fitosanitare të vendit importues.

Me lëshimin e certifikatës fitosanitare nga ana e inspektorit fitosanitar konstatohet se janë plotësuar kushtet nga paragrafët 1 dhe 2 nga ky nen.

Formën dhe përmbajtjen e certifikatës fitosanitare ose certifikatës fitosanitare për riekспорт nga paragrafi 1 dhe 2 nga ky nen i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave sipas formularëve të përcaktuar nga Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e bimëve (IPPC).

Neni 35

#### **Përgjegjësitë e eksportuesve**

Eksportuesit duhet të paraqesin kërkesë për dhënien e certifikatës fitosanitare te inspektori fitosanitar në afat kohor prej 24 orësh nga eksporti i planifikuar.

Kërkesa për lëshimin e certifikatës fitosanitare veçmas përmban:

- të dhëna për paraqitësin e kërkesës, emrin e personit juridik respektivisht emrin dhe mbiemrin e personit fizik dhe selinë e regjistruar ose adresa;
- të dhëna për dërgesën.

Eksportuesit janë të detyruar t'i zbatojnë masat të cilat i ka urdhëruar inspektori fitosanitar gjatë inspektimit fitosanitar të dërgesës së dedikuar për eksport.

## **V/ Transiti**

Neni 36

#### **Transiti i dërgesës**

Inspektimi fitosanitar në pajtim me nenin 24 nga ky ligj nuk është i detyrueshëm në rast të dërgesave në transit.

Dërgesa nga paragrafi 1 nga ky nen doemos duhet të jetë e paketuar në mënyrë që siguron mosekzistimin e rrezikut nga zgjerimi i organizmave të dëmshëm dhe e njëjta nuk guxon të ndahet, kombinohet me dërgesa tjera ose të ripaketohet në rajonin e doganës së Republikës së Maqedonisë.

Nëse ndonjë dërgesë nuk është paketuar në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, ose është bërë shkarkimi i të njëjtës, inspeksioni fitosanitar është i detyruar në pajtim me nenin 24 nga ky ligj.

Pa cenimin e të drejtave nga paragrafi 1 nga ky nen në rast të dyshimit të bazuar për ekzistimin e rrezikut nga futja ose zgjerimi i organizmave të dëmshëm, ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave për disa dërgesa në transit, mund ta përcaktojë mënyrën e trajtimit të dërgesës, inspektimit të detyrueshëm fitosanitar, mënyrën e inspektimit fitosanitar dhe mund t'i përcaktojë masat e domosdoshme.

### **3. LËVIZJA E BIMËVE, PRODHIMEVE BIMORE DHE LËNDËVE DHE OBJEKTEVE TJERA**

Neni 37

#### **Lëvizja**

Bimët, prodhimet bimore dhe objektet dhe lëndët tjera në Listën V.AI mund të lëshohen vetëm nëse pasaporta për bimë është e ngjitur në të njëjtët ose në paketimin e tyre ose është i ngjitur në mjetin e transportit si dokument përcjellës.

Dërgesat e përmendura në Listën V.A që janë lëshuar në qarkullim dhe janë dedikuar për çështje eksperimentale, shkencore-hulumtuese, seleksionuese ose zhvilluese, doemos duhet të shoqërohen me pasaportë për bimët.

#### Neni 38

##### **Lëvizja në zonën e mbrojtur**

Bimët, prodhimet bimore dhe objektet dhe lëndët tjera të përmendura në Listën V.A II, mund të lëshohen në lëvizje në ose në kuadër të zonës së mbrojtur vetëm nëse pasaporta për bimët, që është valide për atë zonë të mbrojtur, është ngjitur në të njëjtët ose në paketimin e tyre ose është ngjitur në mjetin e transportit si dokument përcjellës dhe nëse i plotësojnë kushtet për lëvizje.

Dispozitat nga paragrafi 1 nga ky nen nuk zbatohen për lëvizjen e bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve dhe lëndëve tjera nëpër zonën e mbrojtur ose nga zona e mbrojtur.

Kushtet për lëvizjen e dërgesave nga paragrafët 1 dhe 2 nga ky nen i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

#### Neni 39

##### **Përrjashtime**

Me përjashtim të nenit 37 paragrafi 1 nga ky ligj, sasitë e bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve dhe lëndëve tjera të përmendura në listën V.A, të cilat janë në lëvizje nga ana e prodhuesve të vegjël ose përpunuesve të vegjël, të cilët nuk është e domosdoshme të jenë futur në regjistrin në pajtim me dispozitat nge neni 22 nga ky ligj, mund të lëshohen në lëvizje pa pasaportë për bimë.

#### Neni 40

##### **Prodhimi, përpunimi, përdorimi**

Bimët, prodhimet bimore dhe objektet dhe lëndët tjera të përmendura në Listën V.A I të prodhuara, përpunuara ose shfrytëzuara nga ana e personave juridikë dhe fizikë të futura në regjistrin dhe që janë dedikuar për lëvizje, doemos duhet t'i nënshtrohen inspektimit fitosanitar që të garantohet se:

- të njëjtit nuk janë të sulmuara nga organizma të dëmshëm të përmendur në Listën I.A dhe Listën II.A;
- i përmbushin kushtet e veçanta fitosanitare të përmendura në Listën IV.A.

Bimët, prodhimet bimore dhe objektet dhe lëndët tjera të përmendura në Listën V.A II, të cilat janë dedikuar për lëvizje në zonë të mbrojtur doemos duhet t'i nënshtrohen inspektimit fitosanitar nga shkaqe të përmendura në paragrafin 1 nga ky nen, që të garantohet se:

- të njëjtit nuk janë të sulmuara nga organizma të dëmshëm të përmendur në Listën I.B dhe Listën II.B;
- i përmbushin kushtet e veçanta fitosanitare të përmendura në Listën IV.B.

Inspektimet fitosanitare nga paragrafët 1 dhe 2 nga ky nen zbatohen rregullisht, më së paku gjatë periudhave të përcaktuara kohore ose më së paku një herë në vit dhe së paku në mënyrë vizuale.

Periudhat kohore dhe mënyra e kryerjes së inspektimit fitosanitar nga paragrafët 1,2 dhe 3 nga ky nen i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Me përjashtim nga paragrafi 3 nga ky nen, inspektimet fitosanitare mund të bëhen pa renditje sipas zgjedhjes së rastit që të garantohet gjendja shëndetësore e bimëve dhe pa marrë parasysh prejardhjen e bimëve, prodhimeve bujqësore dhe objekteve dhe lëndëve tjera në cilën do kohë dhe në cilindo qoftë vend ku të njëjtit janë në lëvizje, janë prodhuar, deponuar, përpunuar, shitur ose përdorur në mënyrë tjetër si dhe në lokalet e furnizuesit.

Nëse gjatë inspektimit fitosanitar konstatohet se bimët, prodhimet bimore dhe objektet dhe lëndët tjera paraqesin rrezik nga zgjerimi i organizmave të dëmshëm ose nuk janë plotësuat kushtet e përcaktuara për lëvizjen e tyre, inspektori fitosanitar do të urdhërojë masa të caktuara në nenin 10 paragrafi 3 nga ky ligj.

#### Neni 41

##### **Pasaportat e bimëve**

Pasaportë për bimët jepet për: bimët, prodhimet bimore dhe objekte dhe lëndë tjera të cilat janë të përmendura në Listën V.A.

Pasaportën e bimëve e jep Drejtoria fitosanitare ose personat të cilët japin shërbime publike nga lëmi i shëndetit të bimëve ose personave nga neni 19 paragrafi 1 dhe 2 nga ky ligj, nëse ato janë të autorizuar nga ana e Drejtorisë fitosanitare dhe nëse bimët, prodhimet bimore dhe objektet dhe lëndët tjera të përmendura në Listën V.A i janë nënshtuar inspektimit fitosanitar në pajtim me dispozitat nga neni 40 nga ky ligj.

#### Neni 42

##### **E drejta për dhënien e pasaportave për bimë**

Drejtorja fitosanitare u jep autorizim personave për dhënien e pasaportave për bimë, nëse ato i plotësojnë kushtet vijuese:

- janë regjistruar në regjistrin në pajtim me dispozitat nga neni 19 nga ky ligj;

- në mënyrë profesionale janë kualifikuar për sigurimin e shëndetit të bimëve ose garantojnë se personi i kualifikuar në aspektin profesional për sigurimin e shëndetit të bimëve, i cili është i punësuar do t'i marrë obligimet nga neni 48 nga ky ligj;

- kanë informim formal (letër, notë) nga inspektori fitosanitar me të cilin vërtetohet se i plotësojnë obligimet nga neni 21 nga ky ligj.

Kërkesa për marrjen e autorizimit për dhënien e pasaportës për bimë paraqitet në Drejtorinë fitosanitare sipas formularit të caktuar.

Kërkesa, përveç të dhënave të përmendura në nenin 19 nga ky ligj, përmban edhe:

- të dhëna për llojin e prodhimit, përpunimit, shitjes ose importit të bimëve, prodhimeve të bimëve dhe objekteve dhe lëndëve tjera, për të cilët ka të bëjë autorizimi;

- dëshmi se janë plotësuar kushtet nga paragrafi 1 nga ky nen.

Personat nga paragrafi 1 nga ky nen konsiderohen se janë të kualifikuar në aspekt profesional, nëse të njëjtit kanë më së paku arsim sipëror nga lëmi i shkencave të bujqësisë (prodhimtarisë së bimëve) ose nga shkencat e pylltarisë dhe certifikatë (vërtetim), i cili e vërteton njohjen elementare të organizmave të dëmshëm, asgjësimit të tyre dhe dispozitat nga lëmi i shëndetit të bimëve, të fituar nga kurset programi i të cilëve dhe personat që do të bëjnë aftësim janë të lejuar nga ana e Drejtorisë fitosanitare.

Formën dhe përmbajtjen e formularit nga paragrafët 2 dhe 3 si dhe kushtet për vërtetimin e njohjes elementare sipas paragrafit 4 nga ky nen më për së afërmi i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Autorizimi për dhënien e pasaportës për bimët e jep drejtori i Drejtorisë fitosanitare në afat prej tre muajsh pas pranimit të kërkesës komplet, nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara.

Nëse ndonjë person fizik ose juridik pushon t'i plotësojë kushtet e përcaktuara për dhënien e pasaportave për bimët, autorizimi merret me detyrë zyrtare.

Kundër vendimit për marrjen e autorizimit pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë te ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

#### Neni 43

##### **Evidentimi i personave të cilët japin pasaporta për bimë**

Drejtorja fitosanitare mban evidencë të personave të cilët japin pasaporta për bimë.

Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës nga paragrafi 1 të këtij neni e përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave .

#### Neni 44

##### **Llojet e pasaportave për bimë**

Ekzistojnë llojet e pasaportave për bimë si vijon:

- pasaporta për bimë;

- ndërrimi i pasaportave për bimë (të shënuar si PB) dhe

- pasaporta për bimë për zona të mbrojtura (të shënuar si PM).

Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e pasaportave për bimët nga paragrafi 1 të këtij neni e përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave .

Neni 45

#### **Dhënia e pasaportave për bimë të pa sulmuara, prodhime bimore dhe objekte dhe lëndë tjera**

Nëse me inspektimin fitosanitar konstatohet se një pjesë nga bimët, prodhimet e bimëve dhe objektet dhe lëndët tjera të cilët janë kultivuar, përpunuar ose shfrytëzuar nga ana e prodhuesit dhe kultivuesit të regjistruar ose në mënyrë tjetër janë të pranishme në lokalet e tyre, janë sulmuar nga organizma të dëmshëm nga Listat I.A, I.B, II.A ose II.B, pasaportat për bimët mund të të jepen për pjesën e ngelur nga bimët, prodhimet e bimëve dhe objektet dhe lëndët tjera, nëse nuk ekziston dyshimi se të njëjtat janë sulmuar dhe se nuk ekziston rrezik nga zgjerimi i organizmave të dëmshëm.

Neni 46

#### **Ndërrimi i pasaportave për bimë**

Nëse ndonjë dërgesë është e ndarë ose është e përbërë nga disa dërgesa të ndryshme të veçanta të cilat posedojnë pasaportë të bimëve, për dërgesën e re të prodhuesit të regjistruar, përpunuesit dhe distribuesit doemos duhet t'i lëshohet ndërrimi i pasaportës për bimë.

Nëse në rastin e përmendur në paragrafin 1 nga ky nen, gjendja shëndetësore e dërgesës ndryshon, ndërrimi i pasaportës për bimë mund të lëshohet vetëm pas inspektimit fitosanitar të bërë.

Neni 47

#### **Ndërrimi i pasaportës për bimë me certifikatë fitosanitare**

Pas inspektimit të kryer fitosanitar të dërgesave të importuara, të përmendura në Listën V.A, të cilat doemos duhet të jenë të shoqëruara me certifikatë fitosanitare, inspektori fitosanitar i lejon importuesit, dërgesat e importuara të shkatërrohen në lëvizje në vend me certifikatë fitosanitare në të cilin është e shënuar se ajo paraqet ndërrim të pasaportës për bimë.

Nëse ndonjë dërgesë, e përmendur në Listën V.A, e cila posedon certifikatë fitosanitare është e ndarë ose përbëhet nga disa dërgesa të ndryshme e të veçanta, për dërgesën e re doemos duhet të lëshohet pasaportë për bimë.

Nëse në rastin e përmendur në paragrafin 2 nga ky nen, gjendja shëndetësore e dërgesës së importuar ndryshon, pasaporta për bimë mund të lëshohet vetëm pas kryerjes së inspektimit të dytë fitosanitar.

Neni 48

#### **Obligimet e prodhuesve, përpunuesve, importuesve dhe shpërndarësit në pikëpamje të dhënies së pasaportës për bimë**

Prodhuesit, përpunuesit, importuesit dhe shpërndarësit e bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve dhe lëndëve tjera të përmendura në nenin 19 paragrafi 2 alineja 1 dhe 2 nga ky ligj përveç obligimeve nga neni 21 nga ky ligj, duhet të:

- informojë Drejtorinë fitosanitare për të gjitha ndryshimet në pikëpamje të kushteve për lëshimin e pasaportës për bimë;
- informojnë inspektorin fitosanitar për qëllimin e lëvizjes së bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve dhe lëndëve tjera në zonat e mbrojtura;
- sigurojnë pasaporta për bimët nga personat e autorizuar;
- garantojnë se pasaportat për bimë i kanë përdorur në mënyrë që nuk do të mund të shfrytëzohen dy herë;
- i ruajnë dokumentet dhe të mbajnë evidencë në pikëpamje të lëshimit të të gjitha llojeve të pasaportave për bimë.

Formën, përmbajtjen, mënyrën dhe afatet për informimin si dhe periudhat kohore për ruajtjen e dokumenteve sipas paragrafit 1 nga ky nen i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Neni 49

#### **Obligimet e blerësve të bimëve, produkteve bimore objekteve dhe lëndëve të tjera**

Blerësit e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve dhe lëndëve të tjera, të cilët janë të kyçur në qarkullimin e produkteve të prodhuara ose të përpunuara si konsumatorë të fundit, doemos duhet t'i ruajnë të gjitha llojet e pasaportave për bimë në pajtim me afatet e përcaktuara kohore.

Kohëzgjatjen e ruajtjes së pasaportave nga paragrafi 1 të këtij neni e përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Blerësit e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni doemos duhet t'i mundësojnë inspektorit fitosanitar qasje të bimët, prodhimet bimore dhe në objektet dhe sendet tjera në cilëndo fazë të prodhimit ose përpunimit e tregut dhe t'i mundësojë kryerje të inspektimit fitosanitar duke përfshirë edhe kontrollin e dokumenteve.

### **III. MASA BIOLOGJIKE PËR MBROJTJEN E BIMËVE**

Neni 50

#### **Mbrojtja biologjike e bimëve**

Mbrojtja biologjike e bimëve është strategji për eliminimin e organizmave të dëmshëm në bujqësi dhe pylltari përmes shfrytëzimit të armiëve të gjallë natyrorë, antagonistë ose konkurrentë apo prodhimeve të tyre dhe organizmave të tjerë biotikë vetëreplikantë.

Organizmat nga paragrafi 1 të këtij neni janë: autoktonë dhe ekzotikë (aloktonë).

Neni 51

#### **Llojet autoktone të organizmave**

Lloji autokton i organizmit është lloj që është i pranishëm në mënyrë natyrale në ekosistem në rajon të caktuar.

Bartja, kultivimi dhe shfrytëzimi i llojeve të organizmave autoktonë për shkak të mbrojtjes biologjike të bimëve në sipërfaqe të mbrojtur dhe të hapur kërkuesit i lejohe vetëm nëse janë plotësuar kushtet në lidhje me kapacitetet profesionale dhe teknike të përcaktuara nga ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave në pajtim me ministrin e Ambientit Jetësor dhe Planifikim Hapësinor, e në bazë të kërkesës së parashtruar në Drejtorinë fitosanitare.

Neni 52

#### **Bartja e llojeve të organizmave ekzotikë (alotonë)**

Lloji i organizmit (alokton) ekzotik është lloj i bartur nga njeriu i cili para vendosjes së tij nuk ka qenë i pranishëm në ekosistem të caktuar.

Vetëm ato lloje ekzotike të organizmave të shënuara në listën që e shpall ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave në pajtim me ministrin e Ambientit Jetësor dhe Planifikim Hapësinor dhe për të cilat është dhënë miratimi për import dhe shfrytëzim nga Drejtoria fitosanitare, mund të shfrytëzohen për qëllimet mbrojtjes biologjike të bimëve në sipërfaqe të mbrojtur dhe të hapur.

Drejtoria fitosanitare jep leje për import dhe shfrytëzim të llojeve të organizmave ekzotike nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse vërteton se intervenimi në natyrë nuk paraqet kanosje për balancimin natyror ose llojlllojshmërinë biologjike.

Me përjashtim të dispozitave nga paragrafi 3 i këtij ligji, miratimi për import dhe shfrytëzim të llojeve ekzotike të organizmave mund të jepet për qëllime të mbrojtjes biologjike të bimëve për qëllime eksperimentale hulumtuese-shkencore dhe për qëllime zhvillimore.

Që të merret leja nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, kërkuesi doemos duhet t'i plotësojë kushtet e përcaktuara teknike.

Kërkesa për dhënien e lejes nga paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni parashtrohet në Drejtorinë fitosanitare.

Kërkesa nga neni 51 paragrafi 2 i këtij ligji dhe paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni, në mënyrë të posaçme përmban të dhënat vijuese:

- emrin e personit juridik ose emrin dhe mbiemrin e personit fizik dhe selinë e regjistruar ose adresën;
- personin përgjegjës të personi juridik;
- llojin e veprimtarisë;
- tipin dhe metodën e shfrytëzimit në pikëpamje të organizmave të plotë;
- skenë hyrëse dhe listë të recipientëve;
- vlerësim të rrezikut;
- dëshmi se shfrytëzimi i organizmave është i lejuar së paku në tri vende krahasuese ekologjike evropiane.
- dëshmi se organizmi është i dedikuar për mbrojtje biologjike.

Formën dhe përmbajtjen e listës nga paragrafi 2 dhe kushtet teknike të paragrafit 5 të këtij neni i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Drejtoria fitosanitare mban evidencë për importin dhe shfrytëzimin e llojeve ekzotike të organizmave të përmendur në këtë nen dhe e njëjta dorëzohet në Ministrinë e Ambientit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

#### IV. GRUMBULLIMI, SHFRYTËZIMI DHE KËMBIMI I TË DHËNAVE DHE INFORMATAVE

##### Neni 53

##### **Grumbullimi dhe shfrytëzimi i të dhënave**

Për t'i analizuar dhe për të kryer monitorimin e masave për shëndetin e bimëve, Drejtoria fitosanitare, në bazë të këtij ligji, për qëllime drejtuese dhe për mirëmbajtjen e bazave me të dhëna, mund t'i fitojë dhe t'i shfrytëzojë të dhënat, të cilat ruhen në kuadër të bazave të përcaktuara të të dhënave, nga organet shtetërore, institucionet dhe shërbimet tjera publike, posedues të licencave si dhe organet dhe trupat tjerë të autorizuar.

Drejtoria fitosanitare mund t'i shfrytëzojë edhe planet themelore topografike, grafikët topografikë (hartat), hartat në matje të tokës dhe hartat ortofoto digjitale.

Regjistrat, evidenca dhe bazat tjera me të dhëna të cilat i krijon dhe i mirëmban Drejtoria fitosanitare financohen nga mjetet e siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Mënyra e lidhjes së të dhënave të Drejtorisë fitosanitare me bazat tjera të të dhënave dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave nga bazat tjera të të dhënave i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave në pajtim me rregullat të cilat vlejné për sigurimin e të dhënave.

##### Neni 54

##### **Kumtimi i të dhënave**

Të dhënat nga sfera e shëndetit të bimëve jepen në pajtim me rregullat për qasje të lirë të informatave dhe këtij ligji.

Drejtoria fitosanitare i kumton të dhënat nga regjistrat dhe bazat e të dhënave të organeve tjera shtetërore, organeve të njësisë të vetadministrimit lokal, nëse të njëjtat janë të domosdoshme për kryerjen e kompetencave të tyre, si dhe institucioneve të autorizuar dhe atyre të cilat japin shërbime publike, nëse janë të nevojshme për kryerjen e detyrave nga sfera e shëndetit të bimëve.

Poseduesit e bazave me të dhëna, grafikë dhe harta ortofoto digjitale, të shënuara në nenin 53 paragrafin 2 të këtij ligji, Drejtorisë fitosanitare të dhënat ia kumtojnë pa pagesë, por mund t'i paguajnë shpenzimet e bëra materiale. Poseduesit e bazave të të dhënave, të dhënat i kumtojnë nga neni 53 paragrafi 1 i këtij ligji të cilat kanë karakter të të dhënave personale, në pajtim me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ekstraktet nga bazat e të dhënave të cilat mbahen në pajtim me këtë ligj dhe të cilat nuk përmbajnë të dhëna personale, mund t'u jepen personave që kanë interes juridik, pa marrë parasysh shpenzimet për kumtimin e tyre. Të dhënat e fituara në atë mënyrë mund të shfrytëzohen vetëm për qëllimet për të cilat janë dhënë dhe të njëjtat nuk mund të ndryshojnë ose t'u kumtohen në mënyrë të paautorizuar personave të tjerë.

##### Neni 55

##### **Sistemi informativ**

Ata të cilët sigurojnë shëndet të bimëve doemos duhet të mbajnë evidencë, regjistra dhe baza të të dhënave, të cilat janë të lidhura me sistemin e informatikës dhe të njëjtat duhet t'i ruajnë dhe t'i azhurnojnë në mënyrë të rregullt.

Drejtoria fitosanitare siguron vendosjen dhe lidhjen e sistemit të informatikës të shënuar në paragrafin 1 të këtij neni me sistemin e informatikës të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe me sistemin ndërkombëtar të informatikës nga sfera e shëndetit të bimëve.

Mënyrën e udhëheqjes së evidencës, regjistrave dhe bazave të të dhënave nga paragrafi 1 i këtij neni, i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

##### Neni 56

##### **Këmbimi ndërkombëtar i të dhënave dhe informatave**

Në nivel ndërkombëtar, këmbimi i të dhënave dhe informatave përfshin:

- shërbimin qendror;
  - listën e vendeve të hyrjes përmes të cilëve mund të importohen dërgesa në Republikën e Maqedonisë;
  - listën e organizmave të dëmshëm të cilët i nënshtrohen çrrënjosjes;
  - praninë ose paraqitjen e organizmave të dëmshëm të shënuar në listat e parapara me këtë ligj, në pjesën e territorit ku prania e tyre paraprakisht nuk ka qenë e njohur dhe për masat e ndërmarra.
  - paraqitjen, paraqitjen e menjëhershme ose përhapjen e organizmave të dëmshëm të cilët paraqesin rrezik potencial;
  - paraqitjen e organizmit të dëmshëm në zonë të mbrojtur në lidhje me të cilën zona e mbrojtur ka qenë e definuar si e atillë;
  - ekspertizat nga kontrollimet sistematike në zonën e mbrojtur;
  - rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji;
  - rastet në të cilat dërgesat me bimë, prodhime bimore, dhe me objekte dhe lëndë të tjera janë mbajtur për shkak se nuk i plotësojnë kushtet fitosanitare;
  - të dhënat dhe informatat tjera nga sfera e shëndetësisë së bimëve të përfshira me këtë ligj me kërkesën e organeve dhe organizatave ndërkombëtare.
- Të dhënat dhe informatat do të shpallen në pajtim me konventat ndërkombëtare, kontratat dhe marrëveshjet të cilat i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë.

#### V. SHPENZIMET DHE KOMPENSIMET

##### Neni 57

##### **Shpenzimet**

Të gjitha shpenzimet për testimin e bimëve, produkteve bimore objekteve dhe lëndëve të tjera, të cilat janë bërë me kërkesë të inspektorit fitosanitar për konstatimin e shëndetit të bimëve, në rastin kur rezultatet nga analiza nuk janë në dobi të pronarit, por janë në barrë të pronarit nga i cili janë marrë provat.

Të gjitha shpenzimet për masat e përmendura në këtë ligj, të ndërmarra për sigurimin e shëndetit të bimëve, janë në barrë të pronarit.

Shpenzimet për trajtim teknik për marrjen e autorizimit për dhënien e pasaportave për bimë janë në barrë të kandidatit.

Shpenzimet për të gjitha autorizimet të cilat dalin nga ky ligj janë në barrë të personit juridik dhe fizik, të cilët janë të autorizuar.

Për kryerjen e inspektimit fitosanitar paguhet kompensim i posaçëm.

Lartësinë e kompensimit të posaçëm, si dhe mënyrën e pagesës së saj, llojin dhe sasinë e bimëve, produkteve bimore, objekteve dhe lëndëve të tjera për të cilat paguhet kompensim, si dhe lartësinë dhe mënyrën e pagesës së shpenzimeve nga paragrafët 1, 3 dhe 4 të këtij neni, i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Mjetet nga paragrafët 1, 3 dhe 4 dhe kompensimi nga paragrafi 5 i këtij neni, janë të ardhura të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, dhe do të shfrytëzohen për preventivë dhe masa nga sfera e shëndetit të bimëve nga ana e Drejtorisë fitosanitare, në pajtim me Programin vjetor për shëndetin e bimëve që e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

#### Neni 58

##### **Kompensimi**

Nëse inspektori fitosanitar jep urdhër për shkatërrimin ose eliminimin e bimëve, ose mënjanimin e bimëve, produkteve bimore, objekteve dhe lëndëve të tjera në pajtim me këtë ligj, pronari ka të drejtë të kompensimit, nëse:

- menjëherë ka lajmëruar paraqitjen ose dyshimin e organizmave të dëmshëm nga Lista I.A, Lista II.A, ose në rast të zonës së mbrojtur nga Lista I.B dhe Lista II.B;
- i ka zbatuar të gjitha masat e përcaktuara dhe të urdhëruara për shëndetin e bimëve.

Lartësia e kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohet në bazë të: llojit, moshës, gjendjes e të tjera.

Vlerësim të lartësisë së kompensimit bën Komisioni i formuar nga ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, për të cilën punë paguhet kompensim.

Vendimin për lartësinë e kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni e merr ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Kompensimi nga paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni paguhet nga mjetet e siguruar me Programin për shëndetin e bimëve.

Kompensimi nga paragrafi 1 i këtij neni nuk paguhet nëse organizmat e dëmshëm paraqiten gjatë importit të bimëve, produkteve bimore objekteve dhe lëndëve të tjera në Republikën e Maqedonisë.

Procedura për pagesë të kompensimit për shkatërrimin ose eliminimin e bimëve, produkteve bimore objekteve dhe lëndëve të tjera, zbatohet me kërkesë të pronarit, në bazë të vendimit nga inspektori fitosanitar, raportit me propozim për lartësinë e kompensimit nga Komisioni nga paragrafi 3 i këtij neni, dhe vendimit nga paragrafi 4 i këtij neni nga ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave. Vendimi i inspektorit fitosanitar me të cilin është urdhëruar ndërmarrja e masave dhe raporti për vlerësimin kompensimit nga Komisioni, doemos duhet të bashkëngjiten në kërkesën për kompensim, që duhet të dërgohet në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave - Drejtorinë fitosanitare.

Pronari në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit nga inspektori fitosanitar, mund të parashtrijë ankesë të ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave për ta caktuar kompensimin.

Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit nga inspektori fitosanitar.

Pala mund të parashtrijë ankesë kundër vendimit të miratuar nga ministri nga paragrafi 4 i këtij neni në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit, në Komision për zgjidhjen në shkallë të dytë të punëve administrative nga sfera e bujqësisë, pylltarisë, ekonomisë së ujërave dhe veterinarisë në Ministrinë e Republikës së Maqedonisë.

Kriteret më të përafërta nga paragrafi 2 i këtij neni për përcaktimin e lartësisë së kompensimit, i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

## VI. SHËRBIMET PUBLIKE NGA SFERA E SHËNDETIT TË BIMËVE

#### Neni 59

##### **Shërbime publike**

Shërbime publike nga sfera e shëndetit të bimëve janë aktivitete për kryerjen e punëve nga sfera e përcjelljes, parashikimit të organizmave të dëmshëm dhe aktiviteteve të tjera nga sfera e shëndetit të bimëve dhe atë:

- monitorim dhe përcjellje të organizmave të dëmshëm të cilët zakonisht janë të pranishëm te bimët dhe produktet bimore, parashikimi, përcaktimi i afateve optimale dhe masave për mbrojtje.
- intervenim në rast të dukurive të befasishme të dëmtuesve të karantinës të bimët, dukurive kalamite dhe epifite të organizmave të dëmshëm;
- sigurim të të dhënave meteorologjike, biologjike dhe të dhënave të tjera për qëllimin e përcjelljes dhe parashikimit të dukurisë së organizmave të dëmshëm;
- përcaktim laboratorik dhe diagnostikim të organizmave të dëmshëm;
- edukim të pronarëve dhe personave të tjerë të kyçur në zbatimin e aktiviteteve lidhur me shëndetin e bimëve;
- dhënie e pasaportave për bimë;
- zbatim i aktiviteteve shkencore-hulumtuese dhe aktiviteteve zhvillimore;
- kryerje e dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit për shkak të shëndetit të bimëve;
- kryerje të punëve të tjera teknike.

#### Neni 60

##### **Dhënësit e shërbimeve publike nga sfera e shëndetit të bimëve**

Aktivitetet për dhënien e shërbimeve publike nga sfera e shëndetit të bimëve, i kryejnë personat juridikë dhe fizikë të cilët kanë fituar autorizime publike, dhe persona të tjerë juridikë dhe fizikë nëse i plotësojnë kushtet në bazë të kuadrit profesional, hapësirës dhe pajisjes. Sa i përket kuadrit profesional, të njëjtat duhet të kenë së paku një person me së paku arsim sipëror nga sfera e shkencave të bujqësisë (produktet bimore), ose nga sfera e shkencave të pylltarisë, me përvojë pune prej 3 vjetësh në profesion. Aktivitetet për dhënien e shërbimeve publike nga sfera e shëndetit të bimëve në pylltari, kryhen në pajtim edhe me rregullat nga sfera e pylltarisë.

Kushtet më të përafërta nga paragrafi 1 i këtij neni sa u përket lokaleve dhe pajisjes, i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

#### Neni 61

##### **Obligimet e dhënësve të shërbimeve publike**

Obligimet e dhënësve të shërbimeve publike nga neni 60 të këtij ligji, përbëhen nga:

- aktivitetet e rregullta dhe të vazhdueshme për dhënien e shërbimeve;
- dhënia e shërbimeve të personave fizikë dhe juridikë, të cilët kanë qasje në aktivitete bujqësore dhe pyjore, aktivitete për mbrojtjen e bimëve, dhe personave të tjerë të interesuar;
- dhënia e shërbimeve me çmime të caktuara para-prake.

Obligimet e dhënësve të shërbimeve publike nga sfera e shëndetit të bimëve, janë përcaktuar me lejen nga neni 65 i këtij ligji.

Nëse ndonjë i kyçur në shërbimet publike nuk i jep shërbim publik personit të cilit është i obliguar që t'i japë, ose nuk i ofron shërbim me çmime të përcaktuara dhe me kushtet tjera të parapara, shfrytëzuesi i shërbimit mund të kërkojë nga Drejtoria fitosanitare që ajo të vendosë për të drejtën e tij dhe t'i imponojë atij i cili jep shërbime publike që ta japë shërbimin publik sipas çmimit të përcaktuar paraprakisht.

## Neni 62

**Financimi i dhënësve të shërbimeve publike**

Punët e dhënësve të shërbimeve publike financohen nga:

- të ardhurat personale të realizuara me arkëtimin e çmimit të shërbimeve të dhëna;
- mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për vitin në vijim, të siguruara me transfer për financimin e Programit për shëndetin e bimëve.
- burime të tjera.

## Neni 63

**Çmimet e shërbimeve të dhënësve të shërbimeve publike**

Shfrytëzuesit e shërbimeve publike nga sfera e shëndetit të bimëve, pjesërisht ose plotësisht e paguajnë çmimin e shërbimeve të caktuara, ndërsa disa shërbime mund të jenë pa pagesë.

Lartësinë e çmimeve të shërbimeve nga sfera e shëndetit të bimëve dhe pjesën që duhet të paguhet nga ana e shfrytëzuesve të shërbimeve publike, i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

## Neni 64

**Kontrolli i zbatimit të shërbimeve publike**

Kontroll mbi zbatimin e shërbimeve publike kryen Drejtoria fitosanitare, me përjashtim të shërbimeve publike nga sfera e shëndetit të bimëve në pylltari, të cilat kryhen në pajtim me këtë ligj dhe rregullat nga sfera e pylltarisë.

## Neni 65

**Lejet**

Drejtoria fitosanitare jep leje për dhënien e shërbimeve publike nga sfera e shëndetit të bimëve në bazë të shpalljes publike, i cili botohet së paku në dy gazeta ditore.

Shpallja publike përmban të dhëna për:

- llojin e shërbimit publik për të cilin jepet leja;
- fillimin dhe kohëzgjatjen e lejes;
- kushtet që duhet të plotësohen nga ana e subjektit të cilit i jepet leja;
- të dhënat e detyrueshme në fletëparaqitje;
- kriteret për zgjedhje;
- afatin kohor për dhënien e lejes;
- personin për kontakt për sigurimin e informatave në lidhje me përmbajtjen e shpalljes publike;
- datën, vendin dhe kohën e hapjes së fletëparaqitjeve të konkursit;
- mënyrën e informimit të kandidatëve për zgjedhjen e kryer.

Procedurën për hapjen dhe vlerësimin e ofertave e përcakton Komisioni i caktuar nga ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Përfaqësuesit e autorizuar të kandidatëve mund të jenë të pranishëm gjatë hapjes së fletëparaqitjeve.

Ofertat që do të paraqiten pas afatit të përcaktuar, nuk do të merren në shqyrtim.

Ofertat jo të plota mund të kompletohen në afat prej tetë ditësh nga pranimi i lajmërimit, në të kundërtën oferta nuk do të merret në shqyrtim, për të cilën gjë ofertuesit do të lajmërohen.

Leja për dhënien e shërbimeve publike jepet në formë të vendimit.

Kundër vendimit nga paragrafi 7 i këtij neni pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrijë ankesë në Komisionin për vendosje të shkallës së dytë të punëve administrative nga sfera e bujqësisë, pylltarisë, ekonomisë së ujërave dhe veterinarisë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

## Neni 66

**Marrëveshjet**

Subjektet që kanë marrë leje për kryerjen e shërbimeve publike nga sfera e shëndetit të bimëve, lidhin marrëveshje me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Marrëveshja nga paragrafi 1 i këtij neni lidhet në formë me shkrim dhe në mënyrë të posaçme përmban këto të dhëna për:

- dhënësin e shërbimeve dhe persona profesionalë, të cilët e kryejnë këtë shërbim;
- shërbimet nga sfera e shëndetit të bimëve;
- rajonin në të cilin dhënësi i shërbimeve doemos duhet të japë shërbime publike nga sfera e shëndetit të bimëve;
- mënyrën dhe kushtet për zbatimin e shërbimeve të përcaktuara me marrëveshje;
- të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e dhënësit të shërbimeve;
- kohën dhe mënyrën e kryerjes së shërbimeve;
- fillimin dhe kohëzgjatjen e lejes;
- burimet për financim;
- kontrollin e kryerjes së shërbimeve;
- pushimin e vlefshmërisë së lejes;
- shkaqet për prishjen e marrëveshjes;
- periudhën për prishjen e marrëveshjes e të tjera;

## VII. AUTORIZIME PUBLIKE

## Neni 67

**Autorizime publike**

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave u jep autorizim publik personave juridikë dhe fizikë, të cilët i plotësojnë kushtet sa i përket kuadrit profesional, kapaciteteve hapësinore dhe teknike për detyrat e përcaktuara në nenin 72 pikat 3, 4, 5, 6 dhe 9 të këtij ligji. Sa i përket kuadrit profesional të njëjtit duhet të punësojnë së paku një person, me së paku arsim sipëror nga sfera e shkencave të bujqësisë, drejtimi mbrojtja e bimëve, ose specializim nga sfera e pylltarisë, të kenë të punësuar së paku një person, me së paku arsim sipëror nga sfera e shkencave të pylltarisë, dhe specializim nga sfera për mbrojtjen e bimëve, me përvojë pune prej tri vjetësh. Detyrat nga sfera e shëndetit të bimëve në pylltari të përcaktuara në nenin 72 pikat 3, 4, 5, 6 dhe 9 të këtij ligji i kryejnë personat e përcaktuar me këtë ligj dhe me rregullat që vlejnë për mbrojtjen e pyjeve, si autorizim publik.

Kushtet më të përafërta nga paragrafi 1 i këtij neni sa u përket lokaleve dhe pajisjes, i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave me vendim jep autorizim publik për kryerjen e detyrave nga paragrafi 1 i këtij neni në bazë të konkursit publik.

Kundër vendimit nga paragrafi 3 i këtij neni pala e pakënaqur ka të drejtë të parashtrijë ankesë në afat prej 30 ditësh nga marrja e vendimit në Komisionin për vendosje në shkallë të dytë të punëve administrative nga sfera e bujqësisë, pylltarisë, ekonomisë së ujërave dhe veterinarisë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë.

Bartësit e autorizimeve publike janë përgjegjës para Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave - Drejtorisë fitosanitare për zbatimin e detyrave për të cilat janë ndarë autorizimet publike.

Autorizimi merret nëse bartësi i autorizimit publik nuk i plotëson më kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

Mjetet për kryerjen e autorizimeve publike sigurohen nga Programi për shëndetin e bimëve.

## VIII. KËSHILLI PROFESIONAL PËR SHËNDETIN E BIMËVE

## Neni 68

**Këshilli profesional për shëndetin e bimëve**

Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave themelon Këshill profesional për shëndetin e bimëve, si organ profesional këshilldhënës nga sfera e shëndetit të bimëve, i cili përbëhet nga ekspertë të fushës së shëndetit të bimëve nga bujqësia, pylltaria, shkenca dhe arsimit.

Detyrat e Këshillit profesionale për shëndetin e bimëve janë:

- dhënia e këshillave për inkuorporimin e masave për parandalimin e sjelljes nga jashtë dhe zgjerimin e organizmave të dëmshëm dhe shfarosjen e tyre;
  - propozimi i aktiviteteve shkencore dhe edukative nga sfera e shëndetit të bimëve;
  - përcjellja e zhvillimit dhe çështjeve sistematike nga sfera e shëndetit të bimëve;
  - propozimi i vlerësimeve parësore të rrezikut nga organizmat e dëmshëm;
  - propozimi i planeve zhvillimorë për shëndetin e bimëve;
  - bashkëpunimi dhe përpunimi gjatë hartimit të ligjeve dhe rregullave të tjera;
- Përbërjen, numrin e anëtarëve dhe metodën e punës së Këshillit profesional i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

## IX. KOMPETENCAT E ORGANEVE SHETËRORE

Neni 69

### **Kompetencat e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave**

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë Ujërave mund të lëshojë urdhër për ndërmarrjen e masave si vijojnë, për qëllimet e implementimit të këtij ligji:

- të urdhërojë ndalimin e prodhimit të disa llojeve të farërave dhe bimëve të klonuara në ndonjë sferë;
- ta kufizojë ose ndalojë tregtimin me disa lloje bimore;
- të urdhërojë bashkëpunim të detyrueshëm të pronarëve gjatë shfarosjes së organizmave të dëmshëm dhe shfrytëzimin e pajisjes për këtë qëllim;
- të urdhërojë zbatimin e masave të tjera të domosdoshme për implementimin e ligjit.

Neni 70

### **Drejtoria fitosanitare**

Drejtoria fitosanitare, paraqet organ kompetent për kryerje të punëve në lidhje me shëndetin e bimëve sipas këtij Ligji, përgjegjëse për bashkërenditjen dhe shkëmbimin e informatave ndërmjet organeve dhe trupave shtetërorë dhe për informimin e Unionit Evropian në shkallë të parë në procedurë administrative për çështje nga sfera e shëndetit të bimëve. Drejtoria fitosanitare është përgjegjëse edhe për zbatimin e konventave ndërkombëtare, ujdive dhe marrëveshjeve nga sfera e shëndetit të bimëve, të cilat i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë.

Neni 71

### **Kompetencat e drejtorit të Drejtorisë fitosanitare**

Në qoftë se brenda shtetit ekziston rrezik mbi shëndetin e bimëve në përputhje me nenin 12, paragrafin 3 të këtij Ligji, drejtori i Drejtorisë fitosanitare deri në miratimin e aktit nënligjor, me qëllim të parandalimit të sjelljes nga jashtë dhe zgjerimit të organizmave të dëmshëm në Republikën e Maqedonisë dhe shfarosjen e tyre, mund:

- t'i përcaktojë kufijtë e zonave të rregullta;
- ta kufizojë ose ndalojë lëvizjen e disa llojeve të bimëve në territorin e Republikës së Maqedonisë;
- ta kufizojë ose ndalojë importin ose transitin e disa bimëve në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Neni 72

### **Obligimet dhe detyrat e Drejtorisë fitosanitare**

Përpos obligimeve të përcaktuara në dispozitat e tjera të këtij Ligji, Drejtoria fitosanitare ka përgjegjësi për kryerjen e detyrave dhe obligimeve si vijojnë:

1. bashkëpunim gjatë formulimit dhe implementimit të politikës fitosanitare në sferën e shëndetit të bimëve;
2. hartim të normës ligjore dhe kryerjen e detyrave udhëheqëse administrative nga sfera e shëndetit të bimëve dhe mbikëqyrje mbi zbatimin e tyre;

3. përcjellje, parashikim, përkufizim dhe përcaktim të masave për mbrojtje nga organizmat e dëmshëm;

4. analizë dhe vlerësim të statusit të shëndetit të bimëve me qëllim të përkufizimit të shfaqjes dhe zgjerimit të organizmave të dëmshëm brenda shtetit dhe jashtë tij;

5. përgatitje të vlerësimeve të rrezikshmërisë në rast të rrezikut nga shfaqja ose zbulimi i organizmave të rinj të dëmshëm, dhënia e instruksioneve dhe masave teknike;

6. përpunim të bazave teknike të të dhënave gjatë përcaktimit të zonave të infektuara, zonave të kërcënuara nga ndonjë sulm, zonave të rregulluara në mënyrë të veçantë dhe zonave të mbrojtura;

7. mbajtje të regjistrave, evidentimit dhe të listave të përcaktuara me këtë Ligj;

8. miratim të programeve që kanë të bëjnë me masat preventive kundër sjelljes nga jashtë dhe zgjerimit të organizmave të dëmshëm si edhe të ketë kujdes për implementimin e programeve;

9. zbatim të masave për parandalimin, shfarosjen dhe çrrënjosjen e organizmave të dëmshëm;

10. të inspektimit fitosanitar dhe mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin dhe aplikimin e dispozitave të këtij Ligji;

11. sigurim të masave fitosanitare;

12. kontroll profesional mbi realizimin e detyrave nga ana e personave të autorizuar në përputhje me këtë ligj;

13. njoftim për shfaqjen, dukuri të paparashikuara dhe zgjerim të organizmave të dëmshëm brenda shtetit dhe jashtë tij;

14. hartim të raporteve, analizave, materialeve informative dhe materialeve të tjera për trupat zyrtare, për organet dhe organizatat ndërkombëtare ndaj të cilave Republika e Maqedonisë ka obligim që t'u japë raporte në përputhje me normat dhe mbi bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare;

15. informim të shteteve eksportuese për dërgesa të ndaluara të cilat nuk i përmbushin kushtet fitosanitare;

16. bashkëpunim gjatë hartimit të marrëveshjeve, konventave dhe ujdive ndërkombëtare, të cilat i lidh Qeveria e Republikës së Maqedonisë, nga sfera e shëndetit të bimëve si edhe mbajtja e kujdesit për implementimin e tyre;

17. mbajtje të kujdesit për informimin e opinionit dhe të atyre të cilët janë të interesuar për çështjet nga sfera e mbrojtjes së bimëve dhe botimit të broshurave;

18. mbajtje të kujdesit për zbatimin e procedurave të unifikuara në përputhje me normat dhe kushtet ndërkombëtare;

19. mirëmbajtje të sistemit informatik nga sfera e shëndetit të bimëve;

20. sigurim të trajnimit profesional dhe teknik të punonjësve të Drejtorisë fitosanitare;

21. bashkëpunim me trupa të tjera zyrtare, organe dhe organizata si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij, nga sfera e fushëveprimit të tyre;

22. përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë në trupa, organe dhe organizata ndërkombëtare nga sfera e shëndetit të bimëve;

23. kryerje të detyrave të tjera të ndërlidhura me shëndetin e bimëve të përcaktuara me ligj.

Neni 73

### **Inspektimi fitosanitar**

Inspektim fitosanitar ushtron Drejtoria fitosanitare përmes inspektorëve fitosanitarë.

Inspektorët fitosanitarë bashkëpunojnë me organe të tjera inspektuese, me institucione dhe organizata të tjera dhe me ekspertë të bujqësisë dhe pylltarisë brenda dhe jashtë Republikës së Maqedonisë.

Neni 74

### **Detyrat dhe autorizimet e inspektorit fitosanitar**

Inspektori fitosanitar është i autorizuar që:

1. në çdo kohë dhe në çdo vend të ketë qasje deri te bimët, prodhimet bimore dhe në objekte dhe sende të tjera,

ku të njëjtat janë në lëvizje, ku prodhohen, përpunohen, magazinohen, shiten apo shfrytëzohen në mënyra të tjera, si edhe në lokalet e blerësve dhe gjatë importit, eksportit, rieksporit dhe transitit;

2. në çdo kohë dhe në çdo vend të bëjë inspektim fitosanitar mbi bimët, prodhimet bimore dhe në objekte dhe sende të tjera, ku të njëjtat janë në lëvizje, ku prodhohen, përpunohen, magazinohen, shiten apo shfrytëzohen në mënyra të tjera, si edhe në lokalet e blerësve dhe gjatë importit, eksportit, rieksporit dhe transitit;

3. të ushtrorë kontroll dhe t'i përcjellë organizmat e dëmshëm me ç'rast grumbullohen dhe evidentohen të dhëna për praninë ose mospasjen e organizmave të dëmshëm;

4. ta kontrollojë dokumentacionin fitosanitar të personave juridikë dhe fizikë;

5. të marrë mostra nga bimët, prodhimet bimore dhe nga objekte dhe sende të tjera pa kompensim për vlerën e tyre me qëllim të analizave laboratorike;

6. të verifikojë nëse prodhuesit, përpunuesit, importuesit dhe distributorët e llojeve të caktuara të prodhimeve bimore janë evidentuar në regjistër;

7. të bëjë mbikëqyrje inspektimi mbi përbushjen e kushteve për lëshimin e pasaportave për bimët;

8. të bëjë mbikëqyrje inspektimi mbi përbushjen e detyrimeve të personave përgjegjës për shëndetin e bimëve sipas regjistrat në përputhje me këtë ligj;

9. të bëjë mbikëqyrje inspektimi nëse institucionet publike, personat juridikë dhe fizikë të cilët kanë marrë autorizim për dhënie e shërbimeve publike, sipas këtij ligji, i plotësojnë kushtet e parapara;

10. të bëjë mbikëqyrje inspektimi mbi përbushjen e detyrave të subjekteve të cilat japin shërbime publike;

11. të bëjë mbikëqyrje inspektimi mbi lëshimin e pasaportave të bimëve;

12. të lëshojë certifikata për eksport dhe riekport;

13. të bëjë mbikëqyrje inspektimi mbi regjistrat dhe evidencën e paraparë;

14. të bëjë inspektim fitosanitar mbi eksportin, kultivimin dhe shfrytëzimin e organizmave të dedikuara për mbrojtje biologjike të bimëve;

15. të bëjë mbikëqyrje inspektimi mbi eksportin e mjeteve për mbrojtjen e bimëve;

16. të bëjë mbikëqyrje inspektimi mbi zbatimin e masave sipas këtij ligji;

17. të bëjë mbikëqyrje inspektimi mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji;

18. të përbushë edhe detyra të tjera të lidhura me shëndetin e bimëve.

#### Neni 75

##### **Masat e inspektorit fitosanitar**

Gjatë ushtrimit të inspektorit fitosanitar sipas këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuara mbi bazë të këtij ligji, inspektor fitosanitar është i autorizuar që:

1. ta ndalojë eksportin e organizmave të dëmshëm të cekur në listat e përcaktuara me këtë ligj, dhe të organizmave të tjerë të dëmshëm;

2. ta ndalojë eksportin dhe lëvizjen e bimëve, prodhimeve bimore dhe të objekteve dhe sendeve të tjera, të cilat nuk i plotësojnë kushtet në përputhje me këtë Ligj;

3. ta ndalojë kultivimin e llojeve të bimëve të caktuara për një periudhë të përcaktuar kohore në vendin e prodhimit;

4. të urdhërojë trajtim përkatës të dërgesave gjatë eksportit, importit dhe lëvizjes së bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve dhe sendeve të tjera, nëse konstaton se të njëjtat janë sulmuar nga organizma të caktuar të dëmshëm;

5. të urdhërojë shmangie vetëm nëse një pjesë e dërgesës është sulmuar nga organizma të dëmshëm apo nëse ekziston rrezik nga zgjerimi i organizmave të dëmshëm;

6. të urdhërojë, dërgesa të mos i dorëzohet importuesit, transportuesit ose personave të cilët importojnë apo transportojnë bimë, prodhime bimore dhe objekte dhe sende të tjera, përderisa nuk kryhet inspektimi fitosanitar ose përderisa nuk dihen rezultatet e ekzaminimeve apo të testeve zyrtare;

7. të urdhërojë asgjësimin e dërgesave gjatë importit ose lëvizjes së bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve dhe sendeve të tjera, në qoftë se ekziston rreziku nga zgjerimi i organizmave të dëmshëm apo në qoftë se nuk janë përbushur kushtet sipas këtij Ligji;

8. të lejojë lëvizje të bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve dhe sendeve të tjera (përveç materialit faror dhe rasatit) në rast të infektimit me organizma të dëmshëm në sfera në të cilat nuk ekziston rreziku nga zgjerimi i organizmave të dëmshëm apo deri në vendin e përpunimit industrial nën kontrollin e tyre;

9. t'i ndalojë përkohësisht në tërësi ose pjesërisht, aktivitetet e prodhuesve apo përpunuesve si edhe lëshimin e pasaportave për bimët, deri në konstatimin se organizmat e dëmshëm janë eliminuar;

10. ta ndalojë lëshimin e pasaportave për bimët në rastet kur nuk janë përbushur kushtet për lëshimin e pasaportave;

11. Drejtorisë fitosanitare t'i propozojë shlyerje nga regjistri, në qoftë se konstatohet se personat përgjegjës për shëndetin e bimëve sipas regjistrat nuk i përbushin obligimet e parapara;

12. Drejtorisë fitosanitare t'i propozojë që në rast të shkeljes së serishme t'ua heqë lejen për lëshimin e pasaportave;

13. të propozojë heqje të lejes ose autorizimit në qoftë se nuk janë përbushur kushtet e parapara;

14. ta ndalojë importin, kultivimin dhe shfrytëzimin e organizmave për mbrojtje biologjike të bimëve, në qoftë se nuk janë përbushur kushtet e parapara me këtë ligj;

15. ta ndalojë importin, qarkullimin e brendshëm dhe prodhimin e produkteve për shëndetin e bimëve;

16. të urdhërojë zbatim të masave për korrigjimin e parregullive dhe mangësive sipas këtij ligji, si edhe të akteve nënligjore të miratuara mbi bazë të të njëjtit, brenda afatit të caktuar kohor;

17. të urdhërojë zbatim të masave dhe aktiviteteve të domosdoshme preventive kundër sjelljes nga jashtë, shfaqjes dhe zgjerimit të organizmave të dëmshëm, për të cilat janë të autorizuar me ligj dhe me akte të tjera nënligjore;

18. të shqiptojë dënim mandator aty për aty në raste të përcaktuara me këtë ligj;

19. të ngritë procedurë për shkak të shkeljes së dispozitave të këtij ligji ose të paraqesë kallëzim penal për veprë të kryer penale;

20. të urdhërojë zbatim të masave të tjera në përputhje me këtë ligj.

Për çështjet nga paragrafi 1 i këtij neni, inspektor fitosanitar merr vendim.

Kundër vendimit të inspektorit fitosanitar pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë deri te ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

#### Neni 76

##### **Kushtet për inspektor fitosanitar**

Inspektor fitosanitar mund të jetë personi i/e cili/a ka më së paku arsimim sipëror nga sfera e shkencave bujqësore (prodhimi bimor) ose nga sfera e shkencave pyjore.

#### Neni 77

##### **Dokumente për identifikimin e inspektorit fitosanitar**

Inspektor fitosanitar patjetër duhet të posedojë dokumente identifikimi me të cilët identifikohet gjatë kryerjes së inspektorit fitosanitar.

Dokumente identifikimi janë legjitimacioni dhe emblema të cilat i lëshon dhe heq ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Formën dhe përmbajtjen e formularit të legjitimacionit dhe emblemës nga paragrafi 2 i këtij neni, i përcakton ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

#### Neni 78

##### **Laboratori fitosanitar shtetëror**

Për kryerjen e testeve të specializuara laboratorike mbi bimët, prodhimet bimore dhe mbi objekte dhe sende të tjera në laborator, me qëllim të diagnostifikimit dhe përkufizimit të organizmave të dëmshëm, testeve biologjike, ekzaminimit të cilësive fizike-kimike të mjeteve për mbrojtjen e bimëve, ekzaminimit të materies aktive, ekzaminimit të materialit faror dhe rasatit, formohet Laborator fitosanitar shtetëror në përbërje të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, me status të byrosë.

Me Laboratorin fitosanitar shtetëror udhëheq drejtori, të cilin e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë, sipas propozimit të ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

#### X. MBIKËQYRJA

##### Neni 79

##### **Mbikëqyrja**

Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregullave të nxjerra në bazë të këtij ligji, bën Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave.

Mbikëqyrje mbi zbatimin e autorizimeve publike të përcaktuara me këtë ligj, bën Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave–Drejtoria e fitosanitarisë.

Mbikëqyrje inspektuese mbi zbatimin e këtij ligji dhe përmbardimin e masave të cilat rrjedhin nga ky ligj, bën Drejtoria e fitosanitarisë.

Mbikëqyrjen inspektuese në Drejtorinë e fitosanitarisë e bëjnë inspektorët e fitosanitarisë.

#### XI. DISPOZITA NDËSHKUESE

##### Neni 80

##### **Kundërvajtje**

Me dënim me para në lartësi prej 150.000 deri më 300.000 denarë, do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse:

1. nuk e lajmëron pa shtyrje inspektorin e fitosanitarisë dhe/ose Drejtorinë e fitosanitarisë, për të gjitha paraqitjet e reja ose të papritura të organizmave dëmtuese të përfshira në Listën I.A dhe Listën II.A nga neni 7, paragrafi 2, pika 1 e këtij ligji (neni 5, paragrafi 3);

2. menjëherë nuk e lajmëron inspektorin e fitosanitarisë dhe/ose ofruesit e shërbimeve publike të cilët e lajmërojnë Drejtorinë e fitosanitarisë për të gjitha paraqitjet e reja ose të papritura të organizmave të dëmshme të përfshira në Listën I.A dhe II.A dhe nuk i ndërmerr masat e përcaktuara nga ana e Drejtorisë të fitosanitarisë për parandalimin e përhapjes së organizmave të dëmshme dhe shfarosjen e tyre (neni 6, paragrafi 2);

3. menjëherë nuk e lajmëron Drejtorinë e fitosanitarisë për paraqitjen e organizmave të dëmshme të shënuara në Listën I.A dhe Listën II.A në territorin e Republikës së Maqedonisë ose organizmat e dëmshme të shënuara në Listën I.B dhe Listën II.B në zona të caktuara të mbrojtura ose për paraqitjen e simptomave të bimët, prodhimet bimore ose objekte dhe sende të tjera dhe/ose për dyshimin për praninë e organizmave të dëmshme të shënuara në Listat I.A, II.A, II.B ose II.B (neni 9, paragrafi 1);

4. nuk i mbron bimët, prodhimet bimore ose objektet dhe sendet e tjera dhe nuk e parandalon kontaktin me bimët tjera, prodhimet bimore ose objekte dhe sende të tjera në mënyrë të përcaktuar nga Drejtoria e fitosanitarisë (neni 9, paragrafi 2);

5. jep dhe shpall të dhëna për paraqitjen e organizmave të dëmshëm të porsazbuluar nga Lista I.A dhe Lista II.A në Republikën e Maqedonisë pa lejen e Drejtorisë së fitosanitarisë (neni 11, paragrafi 3);

6. fut ose përhap organizma të dëmshëm në kundërshtim me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji;

7. importon ose vë në qarkullim bimë, prodhime bimore dhe objekte dhe sende të tjera në kundërshtim me dispozitat e nenit 15 të këtij ligji;

8. importon ose lëshon në qarkullim organizma të dëmshëm të shënuar në Listat I.A, II.A, I.B dhe II.B dhe bimë, prodhime bimore dhe objekte dhe sende të tjera të shënuara në Listat III.A, III.B, IV.A dhe IV.B pa i përmbushur kushtet nga neni 16, paragrafi 1, alinetë 1, 2, 3 dhe 4;

9. importon dërgesa për të cilat inspektimi fitosanitar është i domosdoshëm, nëpër vende të cilët nuk janë të përcaktuar si vende për hyrje në Republikën e Maqedonisë (neni 23, paragrafi 1);

10. importon dërgesë nga Lista V.B pa certifikatë fitosanitare (neni 24, paragrafët 3 dhe 4);

11. nuk e njofton inspektorin e fitosanitarisë për arritjen e dërgesave të cilat janë importuar ose janë ringarkuar gjatë transportimit (neni 29, paragrafi 1);

12. nuk i zbaton masat e urdhëruara nga ana e inspektorit të fitosanitarisë për dërgesat të cilat importohen (neni 29, paragrafi 3);

13. nuk i zbaton masat e urdhëruara nga ana e inspektorit të fitosanitarisë për dërgesat e dedikuara për eksportim (neni 35, paragrafi 3);

14. dërgesa nuk është e paketuar në mënyrë e cila e siguron mosekzistimin e rrezikut nga përhapja e organizmave të dëmshëm dhe nëse dërgesa ndahet, kombinohet me dërgesa të tjera ose nëse ripaketohet në rajonin doganor të Republikës së Maqedonisë (neni 36, paragrafi 2);

15. lëshon në qarkullim bimë, prodhime bimore dhe objekte dhe sende të tjera të shënuara në Listën V.A I pa dokument udhëtimi për bimët, të ngjitur mbi bimët ose në paketimin e tyre ose në mjetin e transportimit, si dokument shoqërues (neni 37, paragrafi 1);

16. lëshon në qarkullim, në ose në kornizat e zonës së mbrojtur bimë, prodhime bimore dhe objekte dhe sende të tjera të shënuara në Listën V.A II pa dokument udhëtimi për bimë, i cili dokument është i vlefshëm për atë zonë të mbrojtur, të ngjitur mbi të njëjtët ose në paketimin e tyre ose në mjetin e transportimit, si dokument shoqërues (neni 38, paragrafi 1);

17. ndonjë dërgesë është e ndarë ose është e përbërë nga disa dërgesa të veçanta të ndryshme, të cilat posedojnë dokument udhëtimi për bimët, ndërsa për dërgesën e re, prodhuesit, përpunuesit dhe distributorit të regjistruar nuk i është lëshuar zëvendësim i dokumentit të udhëtimit për bimët (neni 46, paragrafi 1);

18. dërgesa e importuar nga Lista V.A qarkullon në vend pa certifikatë fitosanitare në të cilën është shënuar se ajo paraqet zëvendësim për dokumentin e udhëtimit për bimët (neni 47, paragrafi 1);

19. nuk i kryen obligimet e shënuara në nenin 48, paragrafi 1, alinetë 1, 2, 3, 4 dhe 5;

20. nuk i mundëson inspektorit fitosanitar qasje të bimët, prodhimet bimore dhe objektet dhe sendet tjera në cilëndo fazë të prodhimit ose përpunimit ose në treg dhe nuk i mundëson kryerje të inspektimit fitosanitar, duke e përfshirë edhe kontrollimin e dokumenteve (neni 49, paragrafi 3);

21. shfrytëzon, për qëllimet e mbrojtjes biologjike të bimëve në hapësirë të mbrojtur dhe në të hapur, lloje ekzotike të organizmave, të cilat nuk janë të shënuara në listën ose i importon dhe i shfrytëzon pa lejen e Drejtorisë fitosanitare (neni 52, paragrafi 2);

22. lëshon në qarkullim material faror, material për të mbjellat dhe material për shumim të cilët e kanë prejardhjen nga të mbjellat dhe mbëltime mbi të cilat nuk është bërë

kontrolli i domosdoshëm shëndetësor dhe nuk është lëshuar vërtetim për statusin e gjendjes shëndetësore të të mbjellave ose të mbëltimeve (neni 84, paragrafi 4);

23. lëshon në qarkullim material për mbjellje dhe material për shumim për të cilin prodhuesit, përpunuesit ose distributorit nuk i është lëshuar certifikatë (neni 85, paragrafi 3);

24. nuk i dërgon deklaratë inspektorit fitosanitar dhe lëshon në qarkullim pa leje të Drejtorisë fitosanitare, material për mbjellje dhe material për shumim nga bimë shumëvjeçare, i cili do të mund të përmbante organizma të dëmshëm nga Listat I.A dhe II.A (neni 86, paragrafi 2 dhe 3);

Personit juridik, përveç dënimit në para për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni, do t'i shqiptohet edhe masë sigurie, ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej 6 muajsh deri më 3 vjet.

Personi përgjegjës në personin juridik do të dënohet me dënim me para në lartësi prej 15.000 deri më 30.000 denarë dhe do t'i shqiptohet masë sigurie, ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në zgjatje prej 6 muajve deri më 1 vit për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Personi fizik do të dënohet me dënim me para në lartësi prej 10.000 deri më 15.000 denarë për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 81

#### **Kundërvajtje**

Me dënim me para në lartësi prej 50.000 deri më 150.000 denarë, do të dënohet për kundërvajtje personi juridik, nëse:

1. nuk është futur në regjistrin e prodhuesve, përpunuesve, importuesve dhe distributorëve të bimëve, prodhimeve bimore dhe objekte dhe sende të tjera, ndërsa merret me prodhimtari, përpunim, importim ose shpërndarje të bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve dhe sendeve të tjera nga Lista V.A dhe Lista V.B dhe prodhues të bimëve të caktuara, prodhimeve bimore dhe objekte dhe sende të tjera, të cilat nuk janë të shënuara në Listën V.A dhe qendrat relevante për mbledhje dhe dërgim në sferën e prodhimtarisë (neni 19, paragrafi 1 dhe 2);

2. personi nuk i kryen obligimet e shënuara në nenin 21, paragrafin 1, alinetë 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8;

3. lëshon në qarkullim dërgesa të shënuara në Listën V.A, të cilat janë të dedikuara për punë eksperimentale, shkencore-kërkimore, seleksionuese ose zhvillimore, pa i nënshtuar në inspektim fitosanitar dhe pa dokument udhëtimi shoqëruer për bimët (neni 37, paragrafi 2)

4. nuk siguron inspektim fitosanitar të bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve dhe sendeve të tjera (neni 40, paragrafët 1 dhe 2);

5. lëshon dokument udhëtimi për bimë pa autorizim nga Drejtoria fitosanitare (neni 41, paragrafi 2);

6. lëshon dokument udhëtimi për bimë për pjesën e mbetur të bimëve, prodhimeve bimore dhe objekteve dhe sendeve të tjera, në qoftë se ekziston dyshim se të njëjtët janë të atakuar nga organizma të dëmshëm nga Listat I.A, I.B, II.A ose II.B dhe në qoftë se ekziston rrezik nga përhapja e tyre (neni 45);

7. dërgesa nga Lista V.A e cila posedon certifikatë sanitare është e ndarë ose është e përbërë nga disa kërkesa të veçanta të ndryshme, ndërsa për dërgesën e re nuk i është lëshuar dokument udhëtimi për bimë (neni 47, paragrafi 2);

nuk i ruan të gjitha llojet e dokumenteve të udhëtimit për bimë në përputhje me afatet e përcaktuara (neni 49, paragrafi 1);

8. fut, kultivon dhe shfrytëzon lloje autoktone të organizmave për mbrojtje biologjike të bimëve në hapësirë të mbrojtur dhe në hapësirë të hapur, pa i plotësuar kushtet që kanë të bëjnë me kapacitetet profesionale dhe teknike (neni 51, paragrafi 2);

9. i shfrytëzon të dhënat në kundërshtim me qëllimet për të cilat janë dhënë ose nëse të dhënat i ndryshon pa autorizim ose ua njofton personave të tjerë pa autorizim (neni 54, paragrafi 4);

10. nuk mban evidencë, regjistra dhe baza të të dhënave, të cilat janë të ndërlidhura me sistemin informativ dhe nëse të njëjtat nuk i azhurnon dhe ruan (neni 55, paragrafi 1);

Personit juridik, përveç dënimit me para për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni, do t'i shqiptohet edhe masë sigurie, ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej 6 deri më 18 muaj.

Personi përgjegjës në personin juridik, do të dënohet me dënim me para në lartësi prej 5.000 deri më 15.000 denarë dhe do t'i shqiptohet masë sigurie, ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës në zgjatje prej 6 deri më 9 muaj për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Personi fizik do të dënohet me dënim në para në lartësi prej 3.000 deri më 10.000 denarë për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 82

#### **Dënime në vendngjarje**

Me dënim me para, në lartësi prej 30.000 denarë do të dënohet në vendngjarje personi juridik për veprimet nga neni 80, paragrafi 1, pikat 1, 2, 3, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 20 dhe neni 81, paragrafi 1, pikat 3, 5, 8 dhe 11 të këtij ligji.

Personi fizik do të dënohet në vendngjarje me dënim me para në lartësi prej 3.000 denarë për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni.

## **XII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

Neni 83

#### **Drejtoria fitosanitare dhe përbarimi i detyrave**

Drejtoria për mbrojtjen e bimëve, në ditën e hyrjes së këtij ligji në fuqi, vazhdon të punojë si Drejtoria fitosanitare.

Të punësuarit, pajisja, inventari dhe punët tjera, arkivi, dokumentacioni, mjetet për punë dhe mjetet e tjera nga Drejtoria për mbrojtjen e bimëve, ndërmerren në Drejtorinë fitosanitare.

Neni 84

#### **Vërtetimi për gjendjen shëndetësore të të mbjellave ose të mbëltimeve**

Deri në fillimin e zbatimit të dispozitave të neneve 37, 38, 39, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 57, neni 74, pikat 7 dhe 11 dhe neni 75, paragrafi 1, pikat 9, 10 dhe 12 të këtij ligji, të cilat kanë të bëjnë me dokumentet e udhëtimit të bimëve, mbi të mbjellat për prodhimin e materialit faror, materialit për rasat dhe materialit për shumim do të bëhet kontroll shëndetësor gjatë periudhës së tyre vegetative dhe do të lëshohet vërtetim për statusin e gjendjes shëndetësore të të mbjellave dhe mbëltimeve, sipas rregullave ekzistuese.

Deri më 01 janar të vitit 2009, kontrolli i domosdoshëm shëndetësor dhe lëshimi i vërtetimeve për statusin e gjendjes shëndetësore të mbjellave dhe mbëltimeve do të bëhet nga ana e organizatave të autorizuar në përputhje me rregullat ekzistuese.

Në qoftë se gjatë kontrollit të domosdoshëm shëndetësor të mbjellave ose mbëltimeve sipas paragrafit 2 të këtij neni, gjenden organizma të dëmshëm nga Lista I.A dhe Lista II.A, inspektori fitosanitar urdhëron zbatim të masave për shfarosjen dhe asgjësimin e tyre.

Në raste kur kontrolli i domosdoshëm shëndetësor i të mbjellave ose i mbëltimeve nuk është zbatuar dhe nuk është lëshuar vërtetim për statusin e gjendjes shëndetësore të mbjellave ose të mbëltimeve, në atë rast materialin faror, materialin për mbëltim dhe materialin për shumim, i cili e ka prejardhjen nga këto të mbjella dhe mbëltime, prodhuesi, përpunuesi ose distributori nuk guxon t'i lëshojë në qarkullim.

Në rast kur dispozitat e këtij neni nuk janë të përmbushura, inspektori i fitosanitarisë e ndalon qarkullimin.

Neni 85

**Certifikata për statusin e gjendjes shëndetësore në tregun e vendit**

Deri në fillimin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, të cilat kanë të bëjnë me dokumentet e udhëtimit për bimët, inspektori fitosanitar lëshon certifikatë për statusin e gjendjes shëndetësore të dërgesave të kontrolluara me material për mbëltrim dhe me material për shumim të cilat janë transportuar në Republikën e Maqedonisë.

Certifikata nga paragrafi 1 i këtij neni do të lëshohet, në qoftë se materiali për mbëltrim ose materiali për shumim kanë qenë të vënë nën inspektim fitosanitar para largimit të tyre nga plantacionet dhe objektet në të cilat të njëjtat kanë qenë të prodhuara, të përpunuara ose të paketuara dhe është vërtetuar se janë liruar nga organizmat e dëmshëm të shënuar në Listën I.A dhe II.A, mbi përqindjen e lejuar.

Ndalohet qarkullimi me material për mbëltrim dhe material për shumim për të cilët prodhuesit, përpunuesit ose distributorit nuk i është lëshuar certifikatë sipas paragrafit 2 i këtij neni.

Në rast kur dispozitat e këtij neni nuk janë të përmbushura, inspektori i fitosanitarisë e ndalon qarkullimin.

Neni 86

**Monitorimi i statusit të gjendjes shëndetësore të materialit të importuar për mbjelljen e bimëve shumëvjeçare**

Deri në ditën e hyrjes së Republikës së Maqedonisë në Unionin Evropian, statusi i gjendjes shëndetësore të materialit të importuar për mbjelljen dhe për shumimin e bimëve shumëvjeçare, i cili mund të përmbajë organizma të dëmshëm nga Lista I.A dhe Lista II.A, prania e të cilave nuk mund të vërtetohet gjatë inspektimit fitosanitar gjatë importimit, doemos duhet të vëzhgohet në vendin e shfrytëzuesit të fundit.

Importuesi i materialit për mbëltrim dhe materialit për shumim nga paragrafi 1 i këtij neni, doemos duhet të dorëzojë te inspektori i fitosanitarisë, në kohën e importimit, deklaratë me të dhënat e parapara për shfrytëzuesin e fundit.

Gjatë monitorimit të statusit të gjendjes shëndetësore në vendin e shfrytëzuesit të fundit, materiali për mbëltrim dhe materialit për shumim nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të lëshohet në qarkullim pa lejen e Drejtorisë fitosanitare.

Statusi i gjendjes shëndetësore të materialit të importuar për mbëltrim dhe për shumim, sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të jetë nën monitorim gjatë periudhës së tij vegetative nga ana e inspektorit fitosanitar.

Neni 87

**Afati kohor për lëshimin e akteve të reja nënligjore**

Rregullat më të përafërta të parapara me këtë ligj, do të nxirren më së voni në afat prej tre vjetësh nga hyrja e këtij ligji në fuqi, përveç rregullave në bazë të neneve 20, 21 dhe 22 të cilat do të nxirren në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Listat nga nenet 7 dhe 8 të këtij ligji do të shpallen në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" më së voni në afat prej 3 muajsh nga dita e hyrjes së këtij ligji në fuqi.

Neni 88

**Rregulla të cilat do të zbatohen deri në nxjerrjen e të rejave**

Deri në nxjerrjen e rregullave më të përafërta në bazë të këtij ligji, do të zbatohen rregullat ekzistuese.

Neni 89

**Rregulla të cilat do të pushojnë të vlejshme ose më nuk do të jenë të vlefshme**

Me ditën e hyrjes së këtij ligji në fuqi, pushojnë të vlejshme dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e bimëve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 25/98 dhe

6/2000) përveç dispozitave të ligjit të cilat kanë të bëjnë me mjetet për mbrojtjen e bimëve, të mbjellave bujqësore për prodhimin e farave, mbëltrimet pyjore për prodhimin e farës pyjore, objektet për prodhimin e materialit faror për bimë shumëvjeçare bujqësore dhe pyjore dhe qarkullim të farës dhe materialit faror.

Me ditën e hyrjes së këtij ligji në fuqi, pushon të vlejshme neni 7, paragrafi 1, pika 2 e Ligjit për inspektim bujqësor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 38/2004). 38/2004).

Neni 90

**Zbatimi i dispozitave të caktuara nga ligji**

Dispozitat e neneve 37, 38, 39, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 57, neni 74, pikat 7 dhe 11 dhe neni 75, paragrafi 1, pikat 9, 10 dhe 12 të këtij ligji, të cilat kanë të bëjnë me lëshimin e dokumenteve të udhëtimit për bimët dhe dispozitat e neneve 13, 14, 15, 25 dhe 38 të këtij ligji, të cilat kanë të bëjnë me formimin e zonës së mbrojtur dhe lëvizjen në të, do të fillojnë të zbatohen prej më 01.01 2009.

Neni 91

**Hyrja e Ligjit në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

485.

Врз основа на член 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З

**ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ТРАНСФОРМАЦИЈА НА ЈАВНОТО ПРЕТПРИЈАТИЕ „МАКЕДОНСКИ ЖЕЛЕЗНИЦИ“ - Ц.О. СКОПЈЕ**

Се прогласува Законот за трансформација на Јавното претпријатие „Македонски железници“ Ц.О. Скопје, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 26 април 2005 година.

Бр. 07-1571/1  
26 април 2005 година  
Скопје

Претседател  
на Република Македонија,  
**Бранко Црвенковски, с.р.**

Претседател  
на Собранието на Република  
Македонија,  
д-р **Љупчо Јордановски, с.р.**

**ЗАКОН  
ЗА ТРАНСФОРМАЦИЈА НА ЈАВНОТО ПРЕТПРИЈАТИЕ „МАКЕДОНСКИ ЖЕЛЕЗНИЦИ“ - Ц.О. СКОПЈЕ**

Член 1

Со овој закон се уредува трансформацијата на Јавното претпријатие "Македонски железници" - Ц.О. Скопје (во натамошниот текст: ЈП "Македонски железници").

Член 2

Под трансформација, во смисла на овој закон, се подразбира преобразување на ЈП "Македонски железници" и приватизација на дел од ЈП "Македонски железници" на начин и под услови утврдени со овој закон.

Член 3

Трансформацијата на ЈП "Македонски железници" - Скопје ќе се изврши со поделба на постојното ЈП "Македонски железници" на два нови субјекта:

1. Јавно претпријатие за железничка инфраструктура "Македонски железници" - Скопје и
2. Акционерско друштво за транспорт "Македонски железници Транспорт А.Д." - Скопје.

## Член 4

Во постапката за трансформација на ЈП “Македонски железници”, капиталот, средствата, вработените, правата и обврските на ЈП “Македонски железници” ќе се поделат согласно со планот за поделба изготвен од Министерството за транспорт и врски, а верификуван од Владата на Република Македонија, и тоа:

а) капитал, средства, вработени, права и обврски поврзани со управувањето, изградбата, реконструкцијата, ремонтот, одржувањето, заштитата на железничката инфраструктура, организирањето и регулирањето на железничкиот сообраќај и раководењето со системите за регулирање и безбедност, ќе се пренесат на Јавното претпријатие за железничка инфраструктура “Македонски железници” - Скопје и

б) капитал, средства, вработени, права и обврски поврзани со вршење на железнички превоз ќе се пренесат на Акционерско друштво за транспорт “Македонски железници Транспорт А.Д.” - Скопје.

## Член 5

Трансформацијата на ЈП “Македонски железници” не може да биде на штета на побарувањата на доверителите кон ЈП “Македонски железници” по која било правна основа.

## Член 6

Приватизацијата на Акционерското друштво за транспорт “Македонски железници Транспорт А.Д.” - Скопје, може да се изврши преку продажба на дел или на сите акции со една или повеќе трансакции на инвеститор, и тоа:

- преку тендер во кој е вклучена претквалификација, на начин и по постапка што ги пропишува Владата на Република Македонија и/или

- на друг начин утврден со закон.

Под инвеститор, во смисла на ставот 1 од овој член, се подразбира

а) кое било домашно или странско правно лице кое ги исполнува условите од Законот за железници и

б) меѓународна групација сочинета од најмалку две железнички претпријатија основани во две држави со цел за давање на меѓународни железнички услуги.

## Член 7

Во процесот на трансформацијата, Владата на Република Македонија ќе донесе одлука за издвојување на деловите од ЈП “Македонски железници” - Скопје во кои не се врши суштинската дејност.

Издвоените делови ќе се приватизираат со примена на Законот за трансформација на претпријатија со општествен капитал.

## Член 8

Во процесот на трансформацијата на ЈП “Македонски железници”, Владата на Република Македонија ќе донесе одлука за регулирање на долговите на ЈП “Македонски железници” кон странските кредитори и доверители.

Со одлука на Владата на Република Македонија, ќе се регулираат постојните долгови на ЈП “Македонски железници” кон странските кредитори и доверители кои настанале заклучно со 31 декември 2004 година, а за кои Република Македонија, веќе има издадено државна гаранција.

Со одлука на Владата на Република Македонија, ќе се регулираат обврските и долговите на ЈП “Македонски железници” кон странските кредитори и доверители кои настанале заклучно со 31 декември 2004 година, а за кои Република Македонија дополнително ќе издаде државна гаранција.

## Член 9

Во текот на процесот на трансформацијата на ЈП “Македонски железници”, Владата на Република Македонија со одлука ќе го регулира правото за доделување

на ексклузивитет за вршење превоз по завршување на приватизацијата, со цел да се зголеми атрактивноста на субјектите кои се понудени за продажба, а не на јавниот сектор.

## Член 10

До почетокот на примената на овој закон, основачкиот влог и уделите во постојните друштва со ограничена одговорност основани од едно лице (ДООЕЛ), ќе ги преземе Владата на Република Македонија, како државен капитал и ќе изврши приватизација на овие друштва, согласно со Законот за продажба на државен капитал.

## Член 11

Доколку до почетокот на примената на овој закон, не се изврши продажба на трајните влогови и удели што ЈП “Македонски железници” ги има во други претпријатија, истите стануваат капитал на Јавното претпријатие за железничка инфраструктура “Македонски железници” - Скопје.

## Член 12

Правата на ЈП “Македонски железници”, дозволите, одобренјата и другите акти сврзани со вршењето на дејноста по трансформацијата на ЈП “Македонски железници” се пренесуваат на субјектите од членот 4 на овој закон.

## Член 13

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во “Службен весник на Република Македонија”, а ќе започне да се применува триесеттиот ден од денот на неговото влегување во сила.

**L I G J I  
PËR TRANSFORMIMIN E NDËRMARRJES  
PUBLIKE “HEKURUDHAT E MAQEDONISË” - P.P.  
SHKUP**

## Neni 1

Me këtë ligj rregullohet transformimi i Ndërmarrjes publike “Hekurudhat e Maqedonisë” - P.P. Shkup (në tekstin e mëtejme NP “Hekurudhat e Maqedonisë”).

## Neni 2

Me transformim, sipas këtij ligji nënkuptohet transformimi i NP “Hekurudhat e Maqedonisë” dhe privatizimi i një pjese të NP “Hekurudhat e Maqedonisë” në mënyrë dhe nën kushte të përcaktuara me këtë ligj.

## Neni 3

Transformimi i NP “Hekurudhat e Maqedonisë” - Shkup do të bëhet me ndarjen e NP “Hekurudhat e Maqedonisë” ekzistuese në dy subjekte të reja:

1. Ndërmarrje publike për infrastrukturë hekurudhore “Hekurudhat e Maqedonisë” - Shkup dhe në

2. Shoqëri aksionare për transport “Hekurudhat e Maqedonisë -Transport Sh.A.” - Shkup.

## Neni 4

Në procedurën për transformimin e NP “Hekurudhat e Maqedonisë”, kapitali, mjetet, të punësuarit, të drejtat dhe obligimet e NP “Hekurudhat e Maqedonisë” do të ndahen në përputhje me planin për ndarje të përgatitur nga ana e Ministrisë së Transportit dhe Ndërlidhjeve, dhe i verifikuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, si vijon:

а) kapitali, mjetet, të punësuarit, të drejtat dhe obligimet që kanë të bëjnë me administrimin, ndërtimin, rikonstrukcionin, riparimin, mirëmbajtjen, mbrojtjen e infrastrukturës hekurudhore, organizimin dhe rregullimin e komunikacionit hekurudhor dhe udhëhegja me sistemet për rregullim dhe sigurim, do të mbarten në Ndërmarrjen publike për infrastrukturë hekurudhore “Hekurudhat e Maqedonisë” - Shkup, dhe

